


FERIT  
HALLUNI



Mëngjesi bardhë  
NOVELË


814-32

422

FERIT HALLUNI

# MËNGJES I BARDHË

*Novelë*



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## I

Ndoshta nuk e taproj po të them që ajo mbrëmje ishte një nga më të bukurat e jetës sime. Natyrisht, ju do të gjykon mbi këtë vetëm pasi të keni mësuar shkakun, por unë, që i di me hollësi të gjitha, kam të drejtë të nxitohem paksa dhe t'ju them: Po, ajo ishte vërtet një nga mbrëmjet e mia më të gëzuara. Festoja përvjetorin e dhjetë të martesës dhe jo vetëm kaq. Në dhomën time të pritjes, rrëth tavolinës së gjatë që shkëlqente nga vërniku i freskët dhe nën një dritë të butë e të ngrohtë që derdhej qetësisht prej dy globeve të bardha atje lart, unë kundroja me dashuri pas kaq e kaq kohësh miqtë e mi të zemrës: Myzejenin e mirë e pak të turpshme, Lirinë, «Poeten tonë të madhe» dhe, siç ndodh nganjëherë në të tilla raste, paksa hutaqe, Gencin e qeshur e shakaxhi, i cili, ndonëse tani është thinjur ca, prapëseprapë nuk ka harruar të marrë kitarën me vete dhe, së fundi, të zgjedhurën e mbrëmjes sime të gëzuar, Blertën, shoqen time, motërzën time të bukur e të guximshme, me të cilën dikur ndava gëzimet e shqetësimet e para të punës.

Blerta! Kisha kohë pa e parë dhe nuk çmallesha dot me të duke e shtruar e duke e pyetur për shumë e shumë gjëra. Në fytyrën e hijshme e të rrumbullakët të Blertës,

në sytë e saj të mëdhenj dhe të kaltër ka tani çuditërisht një hije serioziteti dhe unë vë re se, në qoftë se mua jeta bashkëshortore më fali buzëqeshjen, asaj i kishte dhënë një pamje disi hijerëndë. Po ama dukej e kënaqr. Unë e përqafoja herë pas here dhe në një çast, pak më-njanë të tjerëve, e pyeta për diçka intime që kishte të bënte me një ëndërr të saj të shkuar.

— Blerta! — fola me zë të ulët, — a është serioz ky burri yt?

— Çfarë?

Ajo më shikoi një sekondë e hutuar, pastaj siç duket u kujtua dhe buzëqeshi.

— Nuk e paske harruar akoma, Vera?

— Jo, — i thashë, — nuk e kam harruar. A është serioz?

— Shumë, — tha Blerta. — Bile ta kalon dhe ty.

— Nuk është e mundur, — qesha unë.

— Po, — këmbënguli Blerta, — nuk më shikon mua?

— Të shoh, motërsa ime e mirë.

— Pra më beso, po jo si atëherë, ama. Të kujtohet?

— Mos më bëj të skuqem në këtë mbrëmje, Blerta!

— E meriton, — qeshi ajo duke më vështruar në sy.

— Kështu?

— Të shkuara të harruara, — fola e menduar. — A ia ke treguar ngjarjen tonë Aleksandrit?

Aleksandri ishte bashkëshorti i Blertës. Qe një burrë i bëshëm, rrëth të dyzetave, që punonte si ekonomist në komitetin ekzekutiv të rrëthit.

— Patjetër, — tha Blerta, — Pse?

— Jo, kot, ç'thotë?

— Nuk e kam ditur që gruaja ime paskërkë qenë dikur aq e fortë.

— Po pse, nuk je e fortë dhe tani, motërsa ime e mirë?

— Ai gëzohet, Vera, — foli Blerta e kënaqur.

— Nuk e dì, po ajo kohë më ka mbetur gozhdë, — thashë e menduar.

— Nuk bën ta harrojmë, o shoqja ime serioze.

Qeshëm. Genci kishte zënë t'i binte kitarës, ndërsa Liria po rrëmonte diçka në xhepat e çantës. Me siguri kërkonte të deklamonte ndonjë nga ato krijimet e saj poe-tike, të cilat s'i botoi kurrë, po që ne i pëlqenim dhe me plot gojën i quanim «Dafina të poezisë lirike».

Dhoma shkëlgente në dritë. Mbi tavolinën e gjatë qelqet e serviseve feksnin pareshtur, duke lëshuar ca reflekse xixëlluese, kurse në mes dukej sikur u rrezatonte ngrrohtësi një tufë me lule të kaltra. Unë e kisha vendosur qëllimiشت atë buqetë mbi tavolinë. E dija që Blerta i donte shumë ato lule.

— Blerta, — fola unë, që nuk doja të kalonte pa u vënë re ajo buqetë. — Të bie në sy ndonjë gjë?

— Po, — qeshi Blerta, buqeta me lule të kaltra.

Buzëqesha e kënaqur. Një buqetë të tillë me lule të kaltra solli ajo dikur në fshatin e largët L., ku ne ishim bashkë mësuese. E vendosi mbi tavolinën tonë të vogël dhe, që nga ai çast, ajo u bë një pjesëz e jetës sonë në fshat.

— Vera! — u gjallërua papritur Blerta, — ty, besoj, të bie ndër mend ajo buqeta jonë me lule të kaltra artificiale, ë? Kur ika nga fshati ia dhurova Sanijes. Të kujtohet Sanija?

— Sanija!...

Truri im nuk po i qëndronte më vërshimit të kujtimeve dhe, papritur, ky emër, ajo buqetë lulesh të kaltra dhe Blerta u tretën dalngadalë në një gjë të vetme. Dera e dhomës sikur u hap dhe brenda vërshuan menjëherë disa shkulme ere të ftohtë. Ishte erë malesh, ngarkuar me një kundërmim të lehtë mollësh. Solla në mend fshatin.

Dimri i vitit 1956 ia behu shpejt, me të hyrë tectori. Qielli i rimët, si xham i trubullt, u mblodh, pastaj zbriti fare poshtë, i rëndë e i ngrirë, gati të lëshonte ngarkesën e vet të bardhë e të ftohtë. Ngricat zunë përnjëherë dhe toka u bë kallkan. Një erë pickuese, që ndillte drithma, shkundi e i shkretoi degët e mollëve, pastaj zu të hallakatej gjithnjë e më e egër duke ulëritur herë-herë si e marrrosur. Nga ky shkak, dhoma jonë, që nuk kishte asnë farë mbrojtjeje, as nga para as nga prapa (ajo ngrihej në sheshin e fshatit dhe tre muaj më parë kishte qenë dhomë-zyrë e sekretarit të Partisë së zonës), ishte e ftohtë dhe mezi ngrohej. Kështu mendoja unë, që e ndieja shumë të ftohtët, ndërsa Blerta, së cilës kjo gjë nuk i bënte aspak përshtypje ishte e mendjes, dhe këtë e thoshte duke qeshur, se unë duhej të vuaja patjetër nga sëmundja e lartësisë.

Sidoqoftë, dhoma ishte e vogël dhe me dy dritare, njëra prej së cilave vështronte kullën e vjetër të Istrefit, njëqind-dyqind hapa larg dhe tjetra shkollën tonë, një ndërtesë e re, e ulët, me dy klasa. Në të majtë, fshehur mes degëve të mollëve e kumbullave ngrihej shtëpia e Shabës, një fshatari qukapik në fytyrë, i cili në mënyrë të veçantë me ne tregohej i afruar. Tjetër shtëpi aty afër s'kishte. Fshati ishte kryesisht malor, i futur e i shpërndarë mes tri grykave të ftohta, ku erërat rrini paprerë, si në një kazan të stërmadh. Po nga kjo as që donin t'ia dinin banorët e tij dhe merret me mend, as kullat. Përkundrazi, malësorët, që ishin pothuaj të gjithë burra shtatlartë, linin madje dhe gjoksin hapur, duke ruajtur kështu ndoshta një zakon të lashtë me një domethënë të heshtur force e trimërie. Kurse kullat, («fama» e tyre përcaktohej nga burrat e nga gratë që strehonin), ato, të heshtura dhe të ngritura mbi kreshta kodrash, larg njëra-tjetrës, në dimër, kur binte dëborë ngjanin gati-gati si

një kartolinë, ku ashpërsia dhe bukuria rronin së bashku në një harmoni të çuditshme. Vërtet, një hijeshi e ashpër, që për fat të keq gjer atë vit dhe një a dy vite më pas, asnë penel piktori nuk kishte mundur ta fiksonte në letër. Po nejse. Me pak fjalë, sipas një gjeologu, i cili kaloi njëherë asaj ane, kullat ishin një «mrekulli e arkitektonikës malësore», vetë malësorët trima e burra me nam dhe, së fundi, të gjitha këto merrnin frymë një mijë e dyqind metra mbi nivelin e detit.

Se sa të drejtë kishte gjeologu, këtë mendojeni ju, por unë që isha bregdetase, pra e rritur në klimën e ngrohtë të bregut të detit, e mendoja shpesh vetëm këtë të fundit dhe me vete thosha që ai, gjeologu, do të kishte bërë mirë të mos ishte dukur fare andej, ose në fund të fundit të mos fliste, sepse më shumë nga çdo gjë tjetër më ndillte të ftohtë ajo shifër. Një mijë e dyqind metra mbi nivelin e detit!...

Në dhomë kishte rënë heshtja, ndërsa përjashta, muzgu binte ngadalë-ngadalë, i ftohtë e i tejdukshëm. Tutje, në strehën e shkollës, era luante me një teneqe duke prurë kohë pas kohe ca gërvima rrëqethëse.

Sanija, një vajzë rrëth të pesëmbëdhjetave, me një fytyrë paksa të hequr e të këndshme, ishte ulur ndanë tavolinës dhe po qëndiste. Qe një pamje e cila ndillte mendime të bukura. Duart e saj të njoma, të pastërvitura ende mirë, lëviznin avash po me kujdes mbi linjat e një trëndafili që Blerta ia kishte vizatuar në copën e pëlhuarës. Një çast, ajo ngriti kryet dhe foli me një zë të druajtur.

— E kam ba mirë, zonjushë?

I hodha një sy qëndismës. Petalet e mëdha ishin mbushur me fillin e kuq e të ndritshëm të mëndafshit dhe trëndafili kishte marrë tanë pothuaj pamjen e vet të plotë.

— Shumë mirë, Sanije! Të lumtë! Blerta do të gë-zohet kur ta shikojë.

Sytë ë mëdhenj e të shkruar të malësores ndritën nga gëzimi.

— A do të vonohet dhe shumë zonjusha?, — pyeti ajo me një farë padurimi.

— Ja, edhe pak, Sanije. Ndoshta vjen tani.

E dija që ajo mezi priste të vinte Blerta. Prania e saj bënte çdo herë që nga ftyra e hequr e Sanijes të arratisëj në çast druajtja, çelej përnjëherë dhe madje zinte e qeshte, duke e mbushur dhomën tonë me cicërimat e saj të këndshme. Po Blerta nuk po vinte dhe në sytë e Sanijes dukej një farë padurimi.

— Sanije!, — i fola, — ku ke menduar ta vendosësh perden që qëndise?

— Në frëngjinë që sheh nga dhoma juej, zonjushë!  
— tha ajo mbasi u mendua një copë herë.

Buzëqesha. Malësorja e urtë, zakonisht e druajtur, ishte atë çast shembelltyra e vërtetë e një krijese ende të brishtë, por që kishte zënë të hidhët mirë hapat e saj në jetë. Fjalët e fundit ishin shumë kuptimplotë. Ajo shprehte në këtë mënyrë ndjenjat e saj të pastra ndaj nesh.

Hodha vështrimin përtëj dritares. Përjashta nuk dukej njeri. Muzgu po trashej, ndërsa kulla e Istrefit, babait të Sanijes, kishte zënë të përhipej.

— U bë vonë, Sanije! — fola, duke kujtuar babanë e saj të zymtë. — Ndoshta Istrefi të pret.

Ajo u drodh kur dëgjoi emrin e tij. Siç dukej, vetëm atë çast u kujtua që ai e priste në shtëpi. U ngrit dhe lë-vizi.

— Mirë zonjushë, — tha shpejt e shpejt, me një zë ku ndihej qartë keqardhja që atë pasdreke s'do ta takonte Blertën. — Natën e mirë!

— Natën e mirë, Sanije! Mos harro për nesër. Hajde!

Sanija tundi kokën në shenjë pohimi, pastaj me hapa të ngadaljtë doli përjashta. Në dhomë hyri një fjollë ere dhe unë, pa ditur ç'bëja, ngrita shallin e leshtë gjer lart mbi veshë. «Po të ishte tani këtu, Blerta do të tallej me siguri», — mendova unë, pasi shëtita vështrimin nëpër dhomë. Nga faqja e murit përballë, brenda një kornize të punuar hollë me dru arre, buzëqeshte fytyra e ëmbël e Blertës dhe pranë saj, pamja serioze e një burri të thinjur në tëmtha. Ky ishte babai i Blertës. Ajo e kishte vendosur portretin e tij ditën e tretë të ardhjes në fshat dhe duke e vështruar pat thënë: «Nga babai kam marrë guximin, kurse nga nëna dhimbshurinë. Pastaj, fare papritur ia krisi të qeshurit. Po kjo, sido që ta thoshte ajo, ishte më se e vërtetë...»

Pse po vonohej kaq shumë Blerta? Ato ditë formohej kooperativa e parë e zonës dhe ajo, së bashku me Gjokën, sekretarin e Partisë, kishin marrë udhën për në vratat e Prengë Shtjefnit e Mal Kirit, të cilët ngurronin të jepnin fjalën. Ishin dy malësorë, që unë i njihja mirë. Dy burra afër të gjashtëdhjetave, eshtakë në fytyrë, të heshtur dhe me nga një peshqir të hedhur në qafë, si punë shalli. Ishin dy njerëz të ndershëm, që u shkonte mirë fjala në lagjen e sipërme të fshatit. Nga ky shkak, ngurrimi i tyre për kooperativën pat sjellë pengesa. Dy a tri kulla të tjera qëndronin ende nën hijen e heshtjes së dy të parave. Zotërit e tyre thoshin se ishin gati të hynin në kooperativë, po që se Prengë Shtjefni apo Mal Kiri do ta jepnin fjalën e tyre faqe fshatit. Dhe kjo, jo se nuk u besonin sekretarit të Partisë apo shokëve të tjerë, që i kishin nderuar me fjalët e mira me vratat e tyre, por sepse në këto punë duhej edhe mendja e shëndoshë e dy pleqve të përmendur për burrërinë dhe ndershmërinë e tyre. Ndërsa Blerta, e cila kishte qenë dhe një herë tjetër në

kullat e tyre po për punën e kooperativës, ishte e mendimit se në atë mes, veç vargonjve që i lidhnin ata me pronën e tyre të vogël, patjetër që kishte dorë dhe puna e armikut. Sipas saj, ai po tirrte hollë dhe me kujdes pël-hurën e zezë të merimangës.

Të ishte e vërtetë kjo vallë? Deri atë pasdreke vonë, kur unë prisja Blertën dhe ca ditë më pas, përgjigjja e kësaj ishte vetëm ngurrimi i Prengës dhe Mal Kirit me dy-tre malësorë të tjerë dhe asgjë më shumë.

Sekretari i Partisë kishte qenë i mendimit që atje të shkonte dhe Blerta së bashku me të, ndërsa unë do të punoja një temë me rininë e fshatit. Tema bënte fjalë për pronën shoqërore, për të mirat që sillte puna e përbashkët dhe Gjoka e kishte pëlqyer. Unë kujtova zérin e tij të thellë dhe paksa të çjerrë, atë të qeshurën e tij që ia gu-fonte gjoksin e gjerë, pastaj u ula ndanë dritares, Pas pak, aty pranë shkollës u dha Gjoka me Blertën. Diçka po flisnin. Ajo buzëqeshte, ndërsa sekretari i Partisë, i përkulur ca dhe me krahët hapur, dukej sïkur bëhej gati të flakte tutje diçka që unë nuk e shihja. Ajo «diçka» mua më ngjau se duhej të qe ndonjë trung i vjetër, i kalbur, i cili papritur e pakujtuar u kishte zënë rrugën.

Blerta dukej si fëmijë para trupit të tij të madh. Ajo kishte ngritur kökën dhe po e vështronë në sy, si një nxënëse mësuesin e saj të mirë. Kurse sekretari dukej se nuk e kishte mendjen tek ajo. Ai qe veshur me një xha-ketë kadifeje të trashë, pantallona të gjera doku, ndërsa në duar mbante një kasketë lëkure të zezë. Flokët e dendur, të kreher pa kujdes, ia shprishte dhe më keq era dhe ashtu ngjante edhe si punëtor edhe si fshatar. Dhe kjo kishte arsyet e veta. Një vit më parë, ai kishte qenë punëtor në një fabrikë çimentoje. Partia i kishte bërë thirrje dhe ai i ishte përgjigjur menjëherë. Qe nga fshati fqinj dhe sido që prej këtej ishte larguar shumë kohë më parë.

u ambientua shpejt dhe fjala i zinte vend mirë. Malësorët e donin se ishte burrë i drejtë.

Sekretari i Partisë i tha diçka Blertës duke vështruar nga dhoma jonë, pastaj ata u ndanë. Blerta vrapi dhe hapi derën.

— Hë, — e pyeta unë, porsa hyri në dhomë, — pse u vonuat?

— Nuk po më pyet si dolët, — qeshi Blerta duke zhveshur pallton.

— Aty e kam fjalën, — shtova unë.

— Sot pasdreke puna shkoi për bukuri, — tha ajo e kënaqur. Iu afrua sobës që bubullonte nga zjarri dhe zgjati duart përparrë t'i ngrohte.

— Domethënë, Prenga me Mal Kirin u bindën më në fund, — thashë.

— U bindën që ç'ke me të, megjithëse nuk e dhanë përfundimisht fjalën. Po nejse. Gjoka ka një logjikë të shëndoshë.

— E po, sekretar Partie burri i botës...

— Nuk është puna vetëm aty, Vera, — foli Blerta.

— Ai është dhe njeri i mrekullueshëm. Veç ta shihje se si u fliste. Me zemër në dorë. Ishte e qartë se dikush i kishte gënjer, ua kishte prishur mendjen. Jo po toka s'bën, jo po bagëtia do ta humbasë përçorin e vet, sepse do ta bashkojnë në një tufë ku s'do ta marrë vesh i pari të dytin dhe se, edhe ata që kanë shumë krahë pune në shtëpi do të marrin hak po aq sa edhe ata konakë të cilët kanë vetëm një krah pune e të tjera si këto. Dhe mbi të gjitha, kjo puna e kooperativave në male nuk është pjetur ende mirë, prandaj njerëzit nuk duhet të nxitohen të futen, sepse ato do të prishen shpejt.

— Po kjo është punë armiqësore, — belbëzova unë.

— S'do mend, — tha Blerta e menduar dhe me një notë serioziteti, që nuk ishte e zakonshme në fytyrën e saj

— A e morët vesh kush u kishte folur kështu?, — pyeta.

— Jo, nuk flasin. I pengon besa që i kanë dhënë njeri-ut që u ka shkelur në vatër...

— E çuditshme, — murmurita. — Në këtë kohë dhe të mendojnë kështu këta njerëz?!

— Po, — tha Blerta, — Prengë Shtjefni e Mal Kiri kanë jetuar gjithnjë disi të veçuar nga të tjerët dhe doemos, te këta njerëz gjuha e ligë e gjen më lehtë shtratin e vet.

Heshta për disa çaste. «Besa, ky virtyt kaq i lartë i malësorit bëhet nganjëherë padashur strehë e së keqes». Po. Blerta kishte një farë të drejtë, por do të vinte shpejt koha dhe këta njerëz të ndershëm si Prenga me Malin do ta kuptionin të vërtetën. Këtë Gjoka do ta bënte. Të gjithë ne.

Vështrova Blertën dhe buzëqesha.

— Blerta, — fola, — po roli yt në këtë dërgatë?

— Ah, ishte shumë modest — qeshi ajo. — Aq modest, sa në kullën e Mal Kirit nuk fola pothuajse fare.

— Pse?

— Sepse Mali me një pash mustaqe të bardha më shikonte vëngër dhe, kur unë nisa t'i flisja për kooperativën, ai më tha: «Ti, oj mësuese, je vajzë dhe, këtu, në votrën time, nuk asht ba zakon ende të këndojnë pulat... Kjo asht punë burrash, kuvendi dhe vajzave sado të mira të jenë, ende s'u asht ba vendi në kuvend».

— Dhe ti u tërroqe? — pyeta e habitur, ngaqë ajo s'para trembej lehtë nga këto fjalë.

— Jo. Desha t'i flisja, por tamam atëherë ndërhyri Gjoka dhe e di ç'i tha: «Dëgjo këtu, o Mal Kiri! Po e shoh se s'po të pëlqen bash mirë që kjo vajzë, mësuesja jonë, ka ardhur këtu e do të flasë për attë gjë që ti e quan punë burrash, punë kuvendi. Ani mirë. Për këtë flasim

më vonë. Këtu kemi ardhur për një punë tjetër. Le të rrimë pra e të flasim si burrat. Puna është se ndokush si ti ka harruar zakonin e mirë të shqiptarit, t'i dalë përballë erës së ftohtë po të pastër të malit dhe të dëgjojë vetëm erën që vjen prej hatullave, pa e ditë mirë se e kujt është dhe nga hyn».

— Ku e ke fjalën, o sekretar? — ngriti përnjëherë kokën Mal Kiri, të cilit i dogji ajo gjuhë e Gjokës. — Shtegut bjeri drejt.

— Drejt po i bie, o Mal, — shtoi Gjoka duke e vështruar në sy malësorin gjashtëdhjetëvjeçar, i cili brenda atyre pak çasteye dukej sikur ishte thinjur edhe më shumë. — Ti e di fort mirë ku e kam fjalën. Për atë gjuhë të ligë, së cilës ti, pa e peshuar mirë me mend se ku do më dalë ajo, i shtrove sofrën, i dhe zjarrin dhe tashti po i mban anën. A nuk asht kështu?

— Mos, bre burrë, — thirri Mali i prekur në sedër, ndërsa mjekra katrore e thinjur iu drodh. — Në votrën time nuk ka pasë vend kurrë për gjarpën dhe as për gjuhën e tij me helm. Ti e di bash mirë këtë punë.

— E di, prandaj erdhëm të bisedojmë me ty edhe një herë. Por ama mbasi ti ta heqësh nga kryet atë gjuhë që hyri këtu prej hatullave dhe të fryu në vesh me erën e saj të pistë mendime të liga për kooperativën.

Këtu, Mal Kiri heshti një copë herë. Vari kokën dhe për disa sekonda seç pëshpëriti me vete. Pastaj ngriti systë e thellë dhe foli:

— Nuk ban kjo tokë, o sekretar! Asht e varfër, gjithë gurë. Ti e di mirë ç'kemi heqë me të. Me thonj e kemi punue dhe mezi e prumë në fije.

— Sa misër more sivjet prej saj?, — pyeti Gjoka.

— Gjashtë muej bukë, — u përgjigj disi i habitur Mal Kiri, nga kthesa që mori papritur biseda.

— E sa krahë e punuan tokën?, — pyeti sérish Gjoka.

— Ti e di mirë. Tre krahë. Pse?

— Po sikur atë ta punonin gjashtë krahë pune apo dhjetë, sa do të merrje?

— Hesapi rritet, o sekretar, por s'po të marr vesh ku do me dalë.

— Te kooperativa, o Mal, te kooperativa. Ne do ta punojmë të gjithë atë, për të mirën e secilit, për të mirën e fshatit dhe të gjithë popullit. Kurse ti, mos i bjer në qafë kot tokës, se e di boll mirë që po e punove gjithnjë atë, të jep më shumë bukë. Kështu edhe për bagëtinë dhe për gjithçka tjetër.

Mal Kirit i lëvrinë sytë, uli kokën dhe ashtu u duk sikur nuk do ta hapte gojën më. Shtyu zjarrin në vatër dhe heshti. Gjoka theu heshtjen me zërin e tij të thellë, kumbues:

— Hë pra, Mal Kiri! E di që je burrë i ndershëm, e di që ia dëgjon fjalën Partisë. Thuaje pra edhe ti fjalën tënde, ashtu siç ta thotë zemra dhe mendja e shëndoshë.

Mali murmuriti një copë herë me vete, pastaj foli duke i shqiptuar fjalët ngadalë dhe me kujdes:

— Pasha besën, unë kam qenë dhe jam për punë të mira, siç asht kjo e kooperativës, o sekretar, veçse...

— Çfarë?

— Asgja; asgja. Vecse mos ma vini re. Unë...

Tundi kokën i thyer dhe nuk foli më. Gjoka buzëqeshi i lehtësuar.

— Atëherë, të mirë u pafshim, Mal Kiri! Atë punën e erës së hatullave vec, asht mirë ta dijë Partia.

Blertës i ndrisnin sytë kur po tregorët bashkëbisedimin midis sekretarit të Partisë dhe gjashtëdhjetëveçarit Mal Kiri, i cili, siç e tregonte dhe vetë qëndrimi i tij, kishte rënë vërtet në vorbullën marramendëse të asaj «ere» që kishte hyrë nga hatullat në vatrën e vet. Mali nuk e tregoi cila ishte gjuha që vërtiste atë erë. Kështu pra,

ajo ruhej nga besa e malësorit plak. E çuditshme. Por si-doqoftë, pas asaj bisede me Gjokën, në prani të Blertës, Mal Kiri me siguri grindej tani me veten atje, ndanë vat-rës...

Kështu mendoja unë, ndërsa përjashta nata sapo kishte rënë. Në derë u dëgjuan dy trokitje të njohura, pastaj brenda hyri Shaba.

— Mirëmbrama!, — tha ai duke buzëqeshur lehtë.

— Mirë se erdhe, Shabë!, — foli e gjëzuar Blerta. — Urdhëro!

— Ju solla pak dru, — qeshi ai, duke lënë një çast t'i dukeshin dhëmbët e zverdhur e të krimbur nga duhanë. — Po ban shumë ftohtë.

— Të falemi nderit, Shabë!, — foli sërish Blerta.

Ai qëndroi një sekondë pranë derës, pastaj, hoqi opin-gat dhe me një çap të lehtë e të kujdesshëm, sikur druhej të mos zgjonte njeri, iu afrua sobës dhe zbrazi drutë. Në fytyrën e tij qukapike, në lëkurën e përzhitur e të rrudhur gati si një lëvozhgë arre dhe në ato dy sytë e tij të përhimët që vështronin pak si vëngër, kishte një mendim, shfaqja e të cilit, me sa dukej, donte kohë, sepse ai u ul ndanë sobës dhe zu t'i stivoste drutë një nga një dhe mengadalë. Kështu bënte ngaherë kur vinte në dhomën tonë e sillte dru. Në ato raste, ai nuk lejonte në asnje mënyrë që ne të merreshim me stivosjen e druve, dhe unë kukoja gjithnjë se Shaba kishte qejf të rrinte me ne e të shkëmbente ndonjë fjalë.

Ky malësor trupshkurtër, rreth të dyzetave, me dy sy të vegjël të ndezur gati përherë më dukej njeri i çuditshëm. Madje dhe ca enigmatik. Kjo vinte ndoshta ngaqë unë kisha mendimin se ai kërkonte gjithnjë diçka nga ne, po se çfarë ishte kjo, nuk e dija. Ndaj them se ishte dhe ca enigmatik.

Para tre vjetësh kishte qenë i martuar, por e pat ndarë

gruan se nuk i lindte fëmijë dhe tani rronte i vëtmuar, në shtëpinë e tij, fshehur mes degëve të mollëve. Ishte i kamur, mbasë njjeriu që rronte më mirë se kushdo tjetër në fshat.

— Mjaft, Shabë!, — fola unë. — Të falemi nderit!

— S'ka gja, oj zojushë! Nuk jam i lodhur. — U ngrit nga stiva e druve dhe buzëqeshi.

— Kaq herët fillon dimri çdo vit, Shabë?, — pyeti Blerta, pastaj qeshi duke vështruar nga unë.

— Këndeje nga ne, oj zojushë, pleqtë thonë se, kur dimri vjen shpejt, sjell mbarësi. Po ani. Ti a u lodhe andej?

— Nga?! — tha Blerta e habitur.

Andej nga lagjja e sipërme. Ishte me sekretarin, apo jo?

— Ah, po. U lodhëm paksa, o Shabë!

— A e dhanë fjalën Prenga me Malin?

— E dhanë, — foli shkurt Blerta.

— Ashtu?

— Po. Pse?

Shaba mbeti një çast me një shprehje habie në fytyrë. Pastaj vuri buzën në gaz.

— Ani. Bukur fort. S'kishin pse të mos e jepnin. U bë një minutë heshtje. Blerta e shikoi Shabën në fytyrë dhe qeshi.

— Kooperativën po e krijojmë, Shabë! Kurse ti, çfarë pret akoma?

— Nuk po të marr vesh, oj zojushë!, — tha ai paksa i hutuar. — Fol me dritë po deshe.

— E kam fjalën, kur ke ndër mend të martohesh?

Ndjeva përnjëherë të skuqesha në fytyrë. Blerta e ngacmonte nganjëherë Shabën, po ai, çuditërisht, nuk ia merrte për të keq asaj. Përkundrazi. E vështronte një copë herë në sy, pastaj qeshte. Në ato çaste në sytë e tij të vegjël me

zhubra anash ndizej diçka e papërcaktuar, një si dritë e largët, e cila shuhej po aq shpejt sa shfaqej.

— Mos u tall me të shkretin, oj zojushë! E kush më merr mue?

— Hajt, hajt, se e gjen nusen ti. Veç shiko se mos na fejohesh me ndonjë fëmijë në djep.

— Ah, marri, — u hodh e tha me nxitim Shaba, — u ka ikë koha atyne.

— Atëherë mirë, — bëri sikur u qetësua Blerta, — ia ke vënë syrin ndonjërs?

— Besa, me të thanë të drejtën po, oj zojushë!, — hapi gojën dhe qeshi Shaba.

— Kujt?, — tha Blerta.

— Ma mirë po e mbaj për vete, oj zojushë! Fjala që del prej goje nuk asht ma e atij që e nxjerr.

— Po ti duhet të kesh besim te ne, — tha si e prekur Blerta.

— Po mirë pra. Po jua them, veç mos e bani për za.

— Hë pra, kujt?

Në vështrimin e Shabës u dha sakaq një dritë e papërcaktuar, më shumë një si dritë ligësie, e cila humbi shpejt midis buzëqeshjes së tij tërë zhubra.

— Ty, zojushë!

— Çfarë, çfarë?!..., — thirri Blerta e habitur. — Mua?


— Po, oj zojushë. Ty.

— Ik, mor dreq, — ia dha gazit Blerta. — Ti? ...

— Ani. Si të duesh, — ngriti supet me një farë keqardhjeje malësori. Blerta qeshi përsëri, ndërsa Shaba doli përjashta duke lënë prapa një gaz të panatyrshëm. Nuk më erdhi mirë dhe i fola Blertës!

— Blerta!, — fola e skuqur në fytyrë. — çfarë bën kështu? Nuk është mirë të bësh shaka të tilla me të.

— Oi, pa shih, pa shih kulmin e seriozitetit! Po pse, si-



pas teje s'u dashka të bëjmë qoftë dhe një shaka të vogël?... Megjithatë, — shtoi pas pak duke qeshur — çift ideal, ë? Unë dhe Shaba... Kështu. S'ke ç'i thua... — Dhe me disa gjeste që ngjasonin me ato të një çifti të porsamar-tuar, ajo zu të lëvizte nëpër dhomë në një mënyrë të atillë, sa unë nuk munda të përbaheshha. Qesha. Blerta është nga ato vajza, të cilat, do s'do, të bëjnë për vete brenda pak çastesh. Është mjaf e zhdërvjellët, e çiltër dhe pothuaj kurdoherë e gëzuar. Një vit më parë kishte mbaruar pedagogjiken e Tiranës dhe për fshatin ushqente mendime entuziazte. Madje, kishte çaste kur ajo rrëmbehej pas tij tamam si një fëmijë lozonjare. I pëlqenin banorët fjalëpak e të prerë në mendime, ajo mikpritja e tyre e thjeshtë po e pastër «Bukë e kripë e zemër». I pëlqente kori-ja shkëmbore që e ndante fshatin në dy pjesë dhe mbi shtratin e ngushtë të së cilës rridhnin pa pushim ujërat e kulluara të burimeve malore dhe, mbi të gjitha, kullat. Ato, të shpërndara një këtu, një atje, me ato çatitë e tyre të pjerrta, shfaqeshin sidomos mëngjeseve gati si pas një perdeje tyli të përhimët, ku nga çasti në çast pritej të zhvilloheshin ngjarje epike.

Kështu ishte Blerta. Një livadh i tërë pëlqimesh. Po ama, duhet thënë, edhe ajo kishte shqetësimet e saj dhe nganjëherë, papritur e pakujtar binte në mendime. Në ato çaste dhoma bëhej çuditërisht e zbrazët, e ftohtë dhe mua padashur më përqasej sërish ai gjeologu. Imazhi tij i tribullt më ngjante sikur afrohej duke shkelur lart, shumë lart mbi retë, ndërsa qeshte duke treguar diku poshtë detin kaltërosh. Por, kjo zbrazësi qëndillte këtë përqasje, pak a shumë qesharake, ndodhët për fat vetëm disa minuta, sepse më pas çdo gjë rimerrte gjendjen e mëparshme. Fytyra rrumbullake e Blertës çelej, dy sytë e saj të mëdhenj e të kaltër vezullonin sërish nga një dritë e butë dhe e këndshme. Dhoma bëhej prapë e ngrohtë.

Duhet të pohoj se karakteri im ca i zymtë nuk e duronte dot heshtjen. Gëzimi i Blertës ishte çelësi që e shpërndante atë zynti.

## II

Blerta ngriti sytë dhe foli:

— Ah, harrova të të pyes, — tha ajo e menduar, erdhi sot pasdreke Sanija?

— Erdhi, — i thashë. — Madje të priti shumë kohë.

— E mbaroi qëndisjen e perdes?

— Po, dhe i doli për bukurin. Veç ta shihje. Ishte kaq e kënaqur...

— Puna është që të mos e pengojë Istrefi. Ia kam pak frikën atij. Ndoshtha s'do ta lejojë ta vendosë në shtëpi.

— Ku ta dish, por dëgjo, — kujtova thënien e Sanijes.

— Ajo më tha se perden me trëndafil do ta vendosë në dritaren që sheh nga dhoma jonë.

— Me të vërtetë?, — foli e kënaqur Blerta. — Kjo është një gjë shumë e bukur. Sanija është vajzë e zgjuar.

— E po, patjetër, — buzëqesha unë, — shih mësuesen e saj!

Blerta tundi kokën, qeshi pak, pasta nisi të korrigjonte hartimet e nxënësve. Atë çast dera e dhomës trokiti dhe pa pritur përgjigje u hap paksa. Brenda u zgjat si gjithnjë ftytra zioshe e Gencit.

— Mos janë të lira zonjushet tona mësuese?, — pyeti ai.

— Të lira, — u hodh e tha përnjëherë Blerta. — Nga ke humbur kështu, o artist?

Këtë epitet Blerta ia kishte ngjitur Gencit që në maturë. Njëherë ai pat thënë se po kompozonte një këngë, të cilën ua kushtonte «shoqeve të bukura maturante» dhe për këtë, si shpërblim mirësjelljeje, mori nga Blerta epiteten «artist».

- A mund të hyj?, — tha Genci që përjashta.
- Patjetër. Po të presim.
- Puna është të sqarohen më parë ca gjëra.
- E po, hyr, të shkretën, se na ftohe dhomën!
- Kam një shoqe me vete. Si të bëj?, — vazhdoi lojën e tij Genci.
- Asnjë fjalë më shumë -- thirri Blerta gjoja me inat.
- Ose hyr, ose ta mbyllëm derën!
- Ah, jo, jo. Preferoj më mirë të hyj, — foli ai dhe u fut në dhomë. Ne qeshëm, ndërsa Genci shtatlartë dhe simpatik në fytyrë la mbi tavolinë kitaren, pastaj ia krisi edhe ai gazit. Në dhomë, pas tij, u vërsulën disa shkulme ere të ftohtë dhe ajo e humbi për disa çaste ngrohtësinë. Genci iu drejtua menjëherë sobës, duke fërkuar duart e mardhura.

Ai ishte mësues në fshatin fqinj dhe nga ndonjëherë, pasi mbaronte mësimin, bënte ç'bënte vinte në dhomën tonë. Bënte gati rreth dy orë a më shumë në këmbë, po nga kjo nuk ankohej asnjëherë. Përkundrazi, dukej që këtë e kryente me një farë kënaqësie. Kitares i binte për bukuria dhe kjo, afër mendsh qe një gjë e këndshme për ne.

— Hë pra, e solle atë këngën e bukur?, — tha dhe qeshi përsëri me Gencin, Blerta.

— Më lër rehat një minutë, — foli ai i skuqur në fytyrë nga të ftohtët. U ul ndanë sobës dhe zgjati duart përraga. — Bën aq acar, dreqi e mori.

— Vërtet?, — tha Blerta.

— Jo, xhanëm nuk bën dhe aq, — u përgjigj me serio-

zitet Genci. — Veç një fshatar që kishte shkuar në pyll për dru, u kthye në fshat pa hundë. I kishte rënë rrugës.

— Me gjithë mend?, — fola unë me keqardhje.

Blerta u kthye në çast dhe mezi përmbajti gazin. E kuptova që e gjithë kjo s'qe veçse një shaka. Ndjeva parpritur të inatosesha. »Nuk zure mend, o kokë, që ky tallet» — i thashë vetes dhe heshta.

— E di se bëjnë mirë që ju nga bregdeti ju sjellin këtej, në malësi, — tha Genci, kësaj radhe me një buzë-qeshje të lehtë.

— Po tallesh?, — fola unë.

— Aspak. Një mijë e dyqind metra mbi nivelin e detit. E di ç'do të thotë kjo?.. Ah, për pak desh më doli nga mendja. Erdhi gjë përsëri ai gjeologu?

Jo, — murmurita unë e menduar. — Po, ti, sidqoftë, do të bësh mirë sikur të mos ma kujtosh më atë gjeologun, sepse qysh kur ai bëri atë vizitën e tij kalimtare në dhomën tonë, unë, ç'është e vërteta, ndiej më shumë të ftohtë nga ç'kisha më përpara.

— Mirë atëherë, nuk flas më. Stop!, — tha Genci dhe qeshi.

Qesha dhe unë. Pastaj, pas një heshtjeje të shkurtër, biseda ndërroi temë. Fjala u hodh te nxënësit.

— Hë, si i keni çamarrokët? — pyeti i pari Genci.

— Shumë mirë, — tha Blera. — Mësojnë dhe janë të vëmendshëm. Po ti si i ke?

E dini që më bën diçka përshtypje! Nxënësit e kësaj krahine janë të mrekullueshëm në aritmetikë.

— S'ma ha mendja, — kundërshtoi Blera.

— Pse?

— Sepse të njohim ty. S'ke qenë gjë në matematikë. Genci u vrenjt menjëherë.

— E po mirë atëherë, ç'del nga kjo?, — tha ai i pakënaqur.

— Po ja, del ajo që ti s'je në gjendje dhe aq të kapësh prirjet e tyre në këtë lëndë.

— Duhet të më besoni, — vazhdoi seriozisht Genci, disi i prekur. — Duhet të më besoni me sinqueritet. Nxënësit e këtyre anëve kanë një prirje të veçantë, sidomos në aritmetikë. Kjo nuk është vetëm bindja ime.

— Të besojmë, të besojmë, po e di ç'ke ti tani? — qeshi Blerta. — I ngrohe duart? Pa merre atë karakatinën dhe bjeri njëherë!

— Ja tani, për besë, — tha ai i lehtësuar. — Ah, prit! T'i bie kitares, o kulmi i seriozitetit? — shtoi pastaj duke u kthyer nga unë.

Nuk fola. Genci përsëriti pyetjen dhe unë buzëqesha duke miratuar me kokë. Këtë, ai e përshëndeti me një akord la maxhor. Sipas tij, një përgjegjëse shkolle, siç isha unë, meritonte plotësisht një akord me tonalitet të tillë ose, në fund të fundit, kur unë tregohesha «kokëngjeshur», ky tonalitet zbriste në masën tri të katërtat.

Në dhomë ra për pak heshtja. Genci u mendua pak, pastaj zu t'i binte kitares lehtë-lehtë. Tingujt e butë të saj si dhe zëri kumbues e i plotë i Gencit e pushtuan në çast gjithë dhomën. Genci këndonte bukur. Blerta e dëgjonte me kënaqësi dhe nganjëherë e vështronë me ëndje. Madje, shikimet e tyre kryqëzoheshin herë pas here dhe në ato çaste fytyra e saj skuqe, pastaj buzëqeshte. Mos ndoshta ajo... Po të gjykoje nga vështrimet e Blertës dhe nga mënyra se si ajo e priste ardhjen e Gencit në dhomë, unë mendoja se Blerta e donte atë. Të paktën kishte nisur tek ajo interesim, i cili shpesh ka emrin simpati dhe që në fund të fundit, s'është gjë tjetër veçse dashuria në fillimin e vet.

Po për këtë gjë Blerta s'më kishte folur asnjëherë. A ishte e mundur që natyra saj aq e çiltër dhe e guximshme t'i fshihte ndjenjat e veta? Ku ta dish. Për këtë arsy, një

natë, pasi Genci ishte larguar nga dhoma jonë, i fola Blerta për të.

— Blerta!, — pëshpërita me gjysmë zëri në errësirën e dhomës.

— Hë? — tha ajo

— Genci është djalë i mirë, apo jo?

— Çfarë? ..

— Thashë që Genci është djalë i mirë, — përsërita unë.

— Oi, kulmi i seriozitetit, — foli ajo me një notë habie në zërin e saj. — Pse, të pëlqen ty?

U skuqa në fytyrë. Nuk e prisja nga ajo një pyetje të tillë.

— Nuk po bëj shaka, Blerta!, — i thashë.

— Atëherë?

— Fola vetëm për Gencin. Asgjë më shumë.

— E po mirë. Pastaj.

Heshta për disa çaste. Ndjeva që Blerta lëvizi e shqetësuar në shtrat, po nuk foli. Për një çast mendova të mos i thosha gjë, ta lija bisedën me aq, por nuk bënte. E kisha filluar, duhej ta mbaroja. Ajo priste mendimin tim.

— Blerta! Nuk të vjen keq?, — thashë unë duke u përpjekur ta shihja në sy.

Qëshi disi e habitur. Ishte kthyer krejtësisht nga unë, ndërsa koka e saj e bukur u zgjat përpara.

— Pa hë?

— Do të më thuash të drejtën?

— E po fol, të shkretën! Po të ketë gjë për të thënë, ta tregoj.

— Ti e do Gencin?

— Aha, këtu e paske fjalën. Ma mori mendja.

— Po murmurita unë dhe prita.

Jo, Vera!, — foli pas një pauze, Blerta. — Nuk e dua, po nuk e marr vesh, pse e ke ti këtë përshtypje?

— Kot, — ngrita supet. — Mendoja se e doje. Të paktën...

U dëgjua në çast e qeshura e saj, që vazhdoi gjatë deri sa u shua. Ishte një e qeshur, ku ndihej qartë një farë inati, habie dhe humori njëkohësisht. Pastaj foli:

— O kulmi i seriozitetit! Më bëre të qesh me gjithë shpirt. Ti je antike, por ama një antike e pagdhendur mi-rë. Dhe unë kujtoja se vetëm Mal Kiri, Preng Shtjefni e ndonjë tjetër që ka myk në kokë duhen gdhendur, ndërsa paskam harruar që këtu, pranë meje, një vajzë e ré me shkollë, një mësuese, ka nevojë ndoshta të gdhendet edhe më shumë se ata. Dhe unë do ta gdhend. Me daltën time do ta bëj këtë.

Qeshi përsëri, pastaj heshti e u shtrit në shtrat.

— Unë thashë që s'po bëj shaka, Blerta!, pëshpërita.

— Ky është mendimi im.

— Çfarë mendimi moj?, — ngriti zërin ajo.

— Po ja, ta thashë.

— Ai mendim që ke ti, dashur pa dashur, më fyen mua. E di ti këtë ?

— Pse?

— Sepse unë nuk kam nevojë të fshihem prej askujt. Aq më pak prej teje, që të kam shoqe, të kam motër. Nuk më pëlqejnë aspak njerëzit që i fshehin mendimet e tyre, ndjenjat e tyre.

— Mos u inatos, Blerta! Edhe mua s'më pëlqejnë njerëzit që i fshehin mendimet e tyre, prandaj dhe të fala. Po meqë erdhi fjala, çdo të bëje ti sikur ai të të propozonte?

— Kjo do të ishte diçka e papëlqyeshme.

— Përse?

— Sepse do ta refuzoja dhe, kështu, ndoshta, shoqëria e mirë do të ftohej.

— Me gjithë mend?  
— Çfarë me gjithë mend?, — tha Blerta. — Nuk po kuptoj.

— Do ta refuzoje?

U bë një heshtje e shkurtër, gjatë së cilës Blerta m' i nguli sytë e saj të mëdhenj me një shprehje habie në ninëzat e tyre.

— Moj ti, qenke shumë interesant sonte. Unë e di që Genci është vërtet djalë i mirë, por kjo nuk përbën gjithçka pér ta dashur dhe si shok jete, apo jo? Veç kësaj, kam përshtypjen se ai s'di gjë tjetër vetëm të qeshë, dhe mua s'para më pëlqen kështu.

— Tani ma mbushe mendjen, — qesha unë. — Po ti... Nuk arrita t'i jepja fund atij mendimi, sepse Blerta ma preu fjalën në mes:

— Dëgjo këtu, moj budallaqe, —tha ajo ndërsa zëri iu bë papritur i butë. — Unë jam e bindur që Gencit as që i ka kaluar nëpër mend kjo që po thua, por ta zëmë se ashtu është, siç mendon ti. Imagjino tani se çfarë historish do të ketë në çatinë e asaj shtëpie ku do të rrojmë ne! Njëri qesh dhe tjetri qesh. Estradë fare.

Më erdhi pér të qeshur nga mënyra se si foli ajo. Në një farë mase Blerta kishte të drejtë. Genci, një e dy ia kriste të qeshurit, ndërsa ajo, tenxherja kapakun.

— Djali që do të dua, — vazhdoi me zë ëndërrues Blerta, — do të më pëlqente në radhë të parë të ishte serioz. Burrë.

Nuk e përmbajta veten. Qesha. Po kjo, me sa dukej, nuk i pëlqeu Blertës. Ajo e kishte seriozisht.

Nuk tallem, Vera!, — tha ajo me inat. — Kështu do të më pëlqente bashkëshorti im.

— Kurse unë kam pak frikë se mos kërkon të tallesh,  
— qesha me Blertën.

— Vera! — tha ajo.

— Çfarë?

— Natën e mirë!

Mbeta pér disa çaste e habitur. Mënyra se si i dha fund asaj bisede Blerta, la të kuptohej qartë se nuk i kishte ardhur mirë që kisha dyshuar pér të dhe që tani po guxoja të sillesha ashtu me një ëndërr të saj.

Më erdhi keq që u solla ashtu me të, me ëndrrën e saj. Po, na takon nga ndonjëherë në jetë të sillemi me mos-përfillje ndaj mendimeve apo dëshirave të njerëzve tanë të afërt, duke harruar kështu se po shkelim pikërisht zemrën e mikut më të mirë, gjë të cilën nuk do ta dëshironim kurrë, as ta dëgjonim. Dhe vonë, shumë vonë, kur kjo na kujtohet, na skuqet faqja, e pse jo, ndoshta na dhemb dhe zemra. Të gjitha këto unë i provova atë çast. Padashur, unë kisha lënduar mendimin e njeriut që e doja aq fort. Kisha lënduar ëndrrën e saj.

Po, nejse! Që nga ajo kohë, unë nuk i fola më pér Gencin. Ai ishte shoku i mirë i saj, ashtu siç ishte dhe shoku im. Dhe Genci nuk e mori vesh asnjëherë bisedën që u zhvillua atë natë. Ai vinte herë pas here në dhomën tonë dhe veç atyre hidhe e pritjeve tërë kripë që shkëmbëshin sinqerisht në mes tyre, nuk kishte tjetër gjë më të ngrohtë e shoqërore që t'i ngjante.

Genci la kitaren mënjanë dhe buzëgeshi. Blerta falënderoi koncertistin në emrin e «qindra e qindra» spektatorëve, të cilët mbushnin sallën dhe në shenjë respekti i dhuroi atij një lule nga buqeta jonë me lule të kaltra artificiale që ndodhej mbi tavolinë. Genci e pranoi atë me kënaqësi, pastaj luajti rolin e të pakënaqurit ndaj një spektatori, i cili vërtitej nëpër dhomë i zymtë dhe i ftohtë. Ky spektator isha unë.

— Ju lutem, — tha ai, — së paku një duartrokositje.

— Po të jetë se e keni aq të nevojshme, po sakrifikoj,  
— fola unë me të njëjtin seriozitet.

— E po, artistët kanë nevojë për duartrokositje, po aq  
sa ç'kanë dhe për ajër e të tjera gjëra të thjeshta si ai. Pra,  
ju lutem, mos u kurseni.

Unë duartrokita, ndërsa Genci me Blertën ia krisën  
gazit. Pastaj ajo e tërhoqi Gencin pranë tavolinës dhe pas  
pak nisi t'i tregonte disa nga hartimet e nxënësve të saj  
të klasës së katërt.

Në dhomë ra për një copë herë heshtja. Përjashta kishte  
rënë me kohë muzgu i mbrëmjes. Po errej. Nëpër  
hapësirën gjysmë të tejdukshme luhateshin ca gjethë të  
vyshkura, si shpendë të verbër që era i degdiste pa më-  
shirë për kushedi se ku. Larg, në një distancë që nuk përcaktohej  
saktë me sy, ndoshta nga tisi i trubullt i mbrëmjes që i shtonte distancat e sendeve, zu të ndriste zbetë  
një dritë e murgët. Ishte njëra frëngji e kullës së Istrefit.  
Ajo e odës së madhe të zjarrit. Atë çast Istrefi, një  
burrë rrëth të pesëdhjetave, me atë fytyrën e tij të gjerë,  
ku spikaste mjekra katrore e zbardhur para kohe, që ulur  
me siguri ndanë vatrës dhe po ngrohej me zjarrin që lë-  
shonin kërcunjë e mëdhenj. Dhe pranë tij, si një lule e  
bukur, e brishtë, e bija, Sanija. Përsipër veriga dhe në murin  
përballë, lahuta e vjetër. I zoti i saj, Istrefi, ishte në zë  
në gjithë krahinën për mjeshterinë e tij, madje thoshin  
se dikur, kur këndonte ai, lahuta kthehej në send me  
frymë. Po kjo i përkiste vetëm së kaluarës. Istrefi nuk  
i binte më asaj. Që kur e shoqja kishte vdekur, lahuta  
qëndronte varur në mur, e trishtë, e rënduar, pa u marë  
në duart e shkathëta të të zot. E shoqja kishte gati pesë  
vjet që kishte vdekur. Dhe në vatër i pat lënë vetëm një  
fëmijë, Sanjen. Djalë nuk i pat lënë dhe, si çdo malësori  
tjetër pak a shumë të moshuar, kjo ia rëndonte zemrën,  
po megjithatë Sanjen e donte. E kishte edhe vajzë, edhe

djalë. Ajo qe rritur e hajthme në atë ngrehinë, ku era hynte pareshtur nga të çarat dhe vërtitej e ftohtë brenda mureve të nxira nga bloza. Një vit më parë kishte mbaruar filloren dhe i ati se pat lënë më të vazhdonte. Kështu, tiparet e saj të njoma dhe të hijshme kishin marrë shpejt ato të një gruaje dhe Blertës i vinte shumë keq për këtë. Sanija ishte e zgjuar dhe Blerta përpiquej, me sa mundej, që ajo të mos mbetej vetëm brenda katër mureve të kullës. Këtë përkujdesje të saj Sanija e ndiqte në heshtje dhe me kënaqësi. Ajo vinte shpeshherë në dhomën tonë dhe ato çaste bëhej një njeri tjetër. Fytyra i çelej, rimeronte atë njomësinë e mëparshme dhe kur-kur cicërinte nga gëzimi që i shpërthente në shpirt.

Istrefi nuk e pengonte, veç ashtu në heshtje dukej se përpiquej që Sanija të mos takohet shpesh me mësueset. Dhe kjo, për arsyen e thjeshtë që e bija të ishte sa më pranë tij. Këtu, Istrefi i urtë dhe i zymtë, mbasë kishte paksa të drejtë.

E përfytyrova një sekondë atje, ndanë vatrës dhe paritir sepse ndjeva të ftohtë.

— U bë vonë, — tha Genci, duke vështruar përjashta.  
— Më lejo të largohem, o kulmi i seriozitetit?  
— Nisu, Genc! — qeshi Blerta. — Dhe mos harro të vish përsëri me këtë karakatinën tënde, mirë?

— Ah, për pak harrova, — foli Genci, te praku i derës, — si e ke Sanjen?

Blerta u bë përnjëherë e menduar. Sanija kishte hyrë në jetën e saj, si një pranverë e gjallë dhe e përhershme. Ajo i gëzohej asaj si një mëngjesi të bukur, por në të njëjtën kohë kridhej papapndehur në mendime, kur Sanija mungonte ose kur Istrefi e pengonte atë nganjëherë të plotësonte njohuritë e saj.

— Sot nuk e kam parë, — tha Blerta. E prita të vinte po nuk erdhi. Kushedi si e ka punën. I kam dhënë

një libër të lexojë dhe sot pasdreke duhej të më jepte mendimet.

— Çfarë i ke dhënë të lexojë?, — pyeti Genci.

— «Afërdita përsëri në fshat», — tha Blerta.

— Dëgjo!, — buzëqeshi ai. — Janë nja dy vajza atje, në fshatin tim, të cilat nuk i lënë më të vazhdojnë shkollën. Ja, aq sa Sanija janë, katërmbëdhjetë-pesëmbëdhjetëvjeç. A nuk merresh ti me to?

— Në qoftë se mësuesi i atjeshëm ka pushuar së qeni mësues, pse të mos merrem?

— Mësuesi i atjeshëm e ka të vështirë. Ti e kupton.

— Atëherë turp t'i vijë, — qeshi Blerta. — Po e di ç'ke ti? Këtu po krijohet kooperativa e parë e zonës. A nuk pregatisim një grup artistik dhe japim shfaqje në të dy fshatrat?

— Mrekulli, — foli Genci i entuziazmuar. — Si nuk më ka shkuar hiç nëpër mend kjo!

— Duhet të bëjmë diçka dhe ne, — tha Blerta. — Çifteli kemi, lahuta kemi, njerëz që u bien për bukuri kemi, ne të dy nuk jemi dhe aq keq nga zëri, e pse të mos pregatisim një shfaqje. Qysh nesër fillojmë. Mirë? Unë po pregatis dy-tri recitime. Mirë?

— Mirë, — tundi kokën Genci i kënaqur. — Unë po bëj gati tri këngë dhe dy instrumentistë popullorë. Por..., — u kthyte nga unë dhe më shikoi i menduar.

— Çfarë?, — foli Blerta.

— Ky kulmi i seriozitetit, ç'do të bëjë? Apo udhëheqës artistik? Unë nuk ia shkrepja fare në ato punë dhe vura buzën në gaz nga ai propozim i Gencit. Ai po tallej.

Papritur, ai gaz më ngriu në buzë. Ndjeva të rrëqe-thura në trup. Në kuadratin e dritares sytë më zunë një njeri.

— Blerta!, — thirra unë pa mundur ta përbaja veten.

— Çfarë?, — tha ajo e habitur nga ajo kthesë e pa-pritur.

— Shiko!...

— Ku?

— Në dritare.

Kishte kaluar vetëm një çast dhe në dritaren që binte nga kulla e Istrefit nuk dukej asgjë. Njeriu ishte larguar.

— Nuk po kuptoj asgjë, — foli Blerta, — çfarë të shikoj?

— Një njeri po përgjonte në dritare, — murmurita unë.

— Shiko se mos të kanë bërë sytë, — foli Blerta, me sytë nga dritarja.

— Jo. E pashë me gjithë mend. — Ende nuk po më largohej ajo rrëqethje e trupit.

— Prisni, — tha Genci duke qeshur. — Me siguri duhet të ketë qenë lugati. Në prak të dimrit, ai duket gjithnjë në dritaret e shtëpive.

— Mos fol budallallëqe, iu ktheva e shqetësuar atij.

— Unë e pashë mirë. Ja, me këta dy sy.

Blerta më vështroi një copë herë, pastaj doli përvash-ta. Doli dhe Genci. Pas pak ata u kthyen dhe Blerta tha:

— Nuk shihet këmbë njeriu. Ndoshta të është dukur, Vera!

— Të betohem që e pashë në dritare. Zgjati një çast kokën, pastaj iku.

— E njohe?, — pyeti Blerta, kësaj radhe me një farë serioziteti trazuar me kureshtje.

— Jo, — i thashë, — nuk e njoha.

— Ndoshta ka qenë roja ose ndonjë kalimtar i rastit, — foli ajo e menduar.

Heshta për disa sekonda. Ky mendim i Blertës sikur më qetësoi disi, por, pas pak, ndjeva përsëri se po shqetësosheha. Ç'roje mund të kishte aty pranë? ... Veç ku-

llës së Istrefit, shkollës dhe shtëpisë së Shabës diku më tej, aty rrötull nuk kishte asnje objekt që të kishte nevojë për roje. Atëherë kush ishte ai njeri dhe çfarë donte? Ndoshta ishte kalimtar i rastit. Po edhe kjo më dukej e papranueshme. Përse këtij kalimtari i duhej të zgjaste kryet në dritare dhe përsë u largua aq shpejt, kur dëgjoi zërin tim? Jo. Kalimtari i zakonshëm s'duhej dhe s'kishte pse ta bënte këtë. Atëherë... Mendime të zymta zunë të më shkrepnin në kokë.

Dhe nga kjo nuk duhet të çuditet asnjeri. Asokohe unë isha vetëm nëntëmbëdhjetëvjeç dhe nuk isha mësuar ndonjëherë me shfaqje të tillë të papritura. «Po Blerta?, — mund të thotë dikush, — edhe ajo ishte po aq sa ti?». Ai dikush mbasë ka të drejtë, por këtu ndryshon disi puna. Ajo qe mësuar që në fëmijni me vetminë. Ishte bijë oficeri dhe doemos, nga shërbimet e shpeshta të të atit, detyrohej të mbetej herë pas here vetëm, së bashku me të emën. Pastaj, ato ngjarjet që më tregonte Blerta, kur i ati shërbente në organet tona të ndjekjes...

— Aha, — tundi kokën dhe foli me seriozitet Genci.  
— Siç po shoh, mësueset tona kanë nevojë patjetër përnjë roje. Kështu?

— Mos u tall, Genc, — pëshpërita. — Këtu s'ka ndonjë gjë për të qeshur.

— Sidoqoftë, po të doni, unë jam gati të sakrifikoj, — qeshi Genci.

— Nisu tani, Genc, — foli Blerta. — T'u bë vonë dhe ty.

— Atëherë natën e mirë. Bëfshi një gjumë të ëmbël!  
Ai doli dhe në dhomë ra për një copë herë heshtja. Blerta e ndjeu shqetësimin tim, sepse u afrua dhe më buzëqeshi lehtë.

— Ke frikë ti, Vera?

— Jo, Blerta. Vetëm se më shqetësoi pak.

— Afrohu këtu, shoqja ime serioze! Më dëgjo mua!  
— nuk është gjë për t'u shqetësuar.

— Ku di se si më erdhi, Blerta, — thashë e mërzitur.

— Ah, badallaqe!, — qeshi, ajo. Më ngriti paksa kokën dhe, pasi më pa në sy vazhdoi:

— Pa qesh një grimë! Qesh! Trembet mësuesja kështu??

— Mos ma merr për të keq, Blerta! Nuk kam frikë, të betohem, por se si më erdhi.

— Hiqe mendjen tani prej andej. Kushedi, kanë dëgjuar kitaren dhe ndonjë kureshtar është afruar të shikojë. Ja, kaq.

Vuri buzën në gaz, shtypi hundën time me gishtin e saj tregues, pastaj shkoi e u ul pranë tavolinës. Nisi të korrigjonte fletoret e nxënësve, duke mos i dhënë më asnjë rëndësi njeriut, që disa çaste më parë u shfaq në dritaren e dhomës sonë. Ndërsa unë dalngadalë zura të qetësoheshha. Blerta kishte të drejtë. Kujt i duhej ai përgjim në dritare dhe përsë? Po. Me siguri duhej të kishte qenë ndonjë kureshtar, i cili, kur vuri re se e pamë, u largua, ndoshta për të mos rënë në pozitë të vështirë.

Ndjeva frymëmarrjen e qetë të Blertës, bubullimën e zjarrit në sobë dhe një buzëqeshje e vonë zuri vend në fytyrën time. «Hej, budallaqe!, — i thashë vetes. — Përse shqetësohesh kot së koti?!...».

Nata kishte rënë e plotë dhe çdo gjë e kishte mbuluar heshtja.

### III

Të nesërmen zbardi një ditë e kthjellët xham. Frynte një erë e lehtë që kundërmonte aromë mollësh të arrira. Tutje, nga lindja, dielli i kuq si bakër ishte ngjitur paksa

mbi kreshtën e një reje sa një pupël gjigante dhe e vështronte tokën vakët. Dukej taman si një ditë pranvere. Kreshta e puplës së malit qe përskuqur lehtë, si nga ndonjë penel i hollë piktori ngjer në bojë të kuqe dhe kjo e gëzoi pa masë Blertën.

— Shiko, Vera! — foli ajo duke ecur. — Dielli e ka spërkatur me pluhur ciklamin renë. Oh, ç'gjë e bukur!

— Varet nga substanca e resë, — thashë unë e lehtësuar nga ajo pamje e rrallë mes atyre grykave të ftohta.

Blerta nuk foli. Ajo vazhdoi të shijonte atë ngjyrë të pakrahasueshme, e cila përftohej nga dielli mëngjesor dhe ecte. Shkonim për në shkollë. Fshati qe zgjuar si zakonisht herët. Nëpër rrugëzat e tij dukeshin aty-këtu maliesorët. Të heshtur e të ngarkuar gjithsecili me misrin që po e mbartnin nga arat.

Në sfondin e qëruar të qiellit, kullat me oxhaqet e tyre, që villnin pareshtur tym, shfaqeshin të plota, me përmasat e tyre reale. Të ftohta në ngjyrën e tyre të përhimët dhe sikur përtypnin ende mendimet e heshtjen e natës së shkuar.

Në oborrin e kullës së Istrefit, një gjel rrahu nëpër ajër flatrat e kuqe gjak, pastaj ia nisi këngës. Xha Istrefi doli pranë lesës dhe zuri të çante një copë dru të trashë. Blerta e pa dhe i foli:

Mirëmëngjesi, xha Istref!

— Mirëmjesi, oj mësuese!

— Si éshtë Sanija, xha Istref?

Ai e shikoi pak i menduar Blertën, pastaj u përgjigj paksa ftohtë:

— Mirë, oj mësuese, mirë.

— Sot pasdite kam dëshirë ta shoh, — vazhdoi Blerta.

— I thuaj të vijë.

Istrefi nuk dha përgjigje. Murmuriti diçka nëpër buzë, pastaj vazhdoi të çante me ofshama të thella kërcurin

e trashë. Blerta më shikoi një sekondë në sy, po nuk lexoi asgjë veç hutimit tim. Atë çast mua më ngjau se ato «Ahe» të fuqishme që dilnin së thelli nga shpirti i Istrefit kishin diçka edhe nga pakënaqësia që shprehej ndaj dikujt, por që mbulohej prej atij sforcimi fizik të çastit. Ç'kishte pra ai burrë i urtë e i mirë që për herë të parë atë mëngjes po sillej me ne ashtu ftohtë? Nuk fola. Blerta shikoi dhe një herë Istrefin, pastaj foli:

- Nuk po më duket mirë Istrefi sot. Ç'ka?
- Kushedi si e ka hallin, — thashë unë e menduar.
- Shkojmë, Blerta. Nxënësit kanë ardhur.

Në oborrin e shkollës fëmijët po luanin duke vrapuar dhe duke thirrur. Ishin më shumë djem, ca çamarrokë të zgjuar e të vëmendshëm, kurse vajza kishte pak. Disa nga prindërit ngurronin ende t'i dërgonin në shkollë. Ne shkonim herë pas here në kullat e tyre dhe kjo punë po i jepte frytet e veta. Por Istrefi...

— Dëgjo, Vera!, — ndali hapin Blerta. — Nuk e kam parë ndonjëherë Istrefin kështu si sot. Më la përshtypje të keqe.

— Mos ka të bëjë gjë me atë qëndisjen, — thashë unë, sepse po vë re që Sanija nuk e ka vënë perden me trëndafil në dritaren që sheh nga dhoma jonë.

— Sikur të jetë vetëm kjo, nuk është dhe aq keq, — tha ajo dhe buzëqeshi lehtë.

Hymë në oborrin e shkollës. Nxënësit e ndërprenë lojën përnjëherë.

— Mirëmëngjesi zonjushë!

— Mirëmëngjesi zonjushë!

Kjo përhëndetje kaq e njojur shpërtheu gati menjëherë në të gjithë oborrin e shkollës dhe, si çdo herë tjetër, i dha një kuptim të ri ditës për ne. Ishte vërtet një çast i gëzueshëm, të cilin nuk mund ta përshkruash dot me fjalë. Ai i ngjante gati-gati një interviste, ku të dy palët,

si trupa e nderit (nxënësit porsa na shihnin linin lojën dhe ashtu pa u ndier rreshtoheshin në të dy krahët, duke lënë në mes një copë rrugë), ashtu dhe ne, që na takonte ky nderim, pëshpërisnim vetëm përshëndetjen e ngrohtë: «Mirëmëngjesi zojushë! . . .» «Mirëmëngjesi fëmijë!».

Blerta e harroi në çast Istrefin. Ajo ishte shend e verë. Pas pak u futëm nëpër klasa. Brenda bënte ftohtë. Puna e parë, duhej ndezur zjarri.

— Nuk paska sjellë dru Shaba?, pyeti Blerta me zë të lartë një nxënës.

— Jo, zonjushë! — u përgjigj ai, duke e shikuar në sy Blertën. Ishte një djale rrëth dymbëdhjetëvjeç, kokëqethur dhe me ca sy që vështronin vëngër. — Shaba ka qenë sëmurë mbramë, zonjushë!

— Sëmurë?! — zgjati kokën Blerta.

— Po, zonjushë!

— Kush të tha ty, Nikë?

— Shaba, zonjushë! Ai ishte mbramë në kullën tonë.

— Mirë, tha Blerta. — Shko dhe merr ca dru në dhomën tonë.

Djali kokëqethur u zhduk në çast me vrap. Pas disa çastesh u kthye me një barrë dru, në duar dhe zjarri u ndez shpejt. Mësimi filloi. Atëherë, ne e bëним mësimin në dy klasa kolektive. Unë kisha të parën dhe të tretën, ndërsa Blerta të dytën dhe të katërtën. Që nga klasa e saj vinin herë pas here zëra. Mes tyre, unë dalloja menjëherë tingullin kumbues të zërit të Blertës, dhe fare përrit gzin e nxënësve. «Sigurisht, ka bërë ndonjë nga ato shakatë e saj tërë kripë dhe ata qeshin», — mendoja unë dhe vija buzën në gaz. Blerta dinte të komunikonte aq bukur me nxënësit e saj, sa edhe unë e kisha zili, ndonjëse për mua shpesh thuheshin fjalët më të mira në raportet e seksionit të arsimit. Kurse për Blertën, ç'është e vërteta, nuk kishte ndonjë mendim të mirë apo të keq, që

të ishte shprehur së paku në ndonjë shkresë a mbledhje. Po sidoqoftë, për mua ajo ishte një mësuese e mirë, nga ato të pakta mësuese, puna e të cilave, nuk para binte në sy menjëherë. Nxënësit e donin Blertën, e dëgjonin me vëmendje dhe veç këtyre fshati e respektonte. Kjo ishte mjaft për një mësuese.

Trokiti dera. Një trokitje e rëndë dhe e ngadaltë. Pastaj e nxituar. «Kështu trokasen vetëm të shkalluarit», mendova unë dhe hapa derën. Nuk e di pse, ngriva në vend. Ndoshta ngaqë nuk e mendoja kurrë që atë çast ai të dukej aty. Në prakun e derës kishte qëndruar Prenga, Prengë Shtjefni dy metër i gjatë, me mustaqet e mëdha të kërleshura dhe me fytyrën e grunjtë, të vrenjtur. Vajza e tij e vogël ishte nxënëse e Blertës.

— Urdhëroni, shoku Prengë! — mezi fola unë e zënë ngushtë. Deri atë çast ai nuk kishte shkelur asnjëherë prakun e shkollës dhe ajo pamja e tij e rëndë më la përshtypje të keqe.

— Desha pak vajzën time, — foli Prenga, me zërin e tij të ngjirur dhe gjithnjë i vrenjtur në fytyrë.

— Pse?

— E desha, ia preu shkurt ai.

— Është në klasën përkarshi, — fola duke treguar derën tjetër. — Shkoni tek ajo, apo doni t'jua thérres unë?

— Po të duesh.

Mbeti në këmbë pa lëvizur, i rëndë e i heshtur si një shkëmb. Trokita në derën e klasës tjetër dhe pas pak doli Blerta. Ajo e pa menjëherë Prengën dhe buzëqeshi. Si duket e gjëzoi prania e tij aty.

— Ah, urdhëro Prengë! Urdhëro!

I zgjati dorën malësorit, por ajo i mbeti pezull një minutë. Uli dorën duke u skuqur në fytyrë.

— Nuk kam ardhë me ndejtë, jo, — tha Prenga i zymtë. Desha pak vajzën time.

— Po ajo është në mësim tanë, — foli Blerta e hutuar.

— S'ka galje, jo. Ma qit përjashta.

— A ka ndodhur gjë, Prengë?, — pyeti Blerta disi e shqetësuar.

— Jo, jo. Asgja. Ma qit përjashta, thashë!

— Unë jam mësuesja e saj, Prengë!, — ngriti zërin Blerta. — Dhe duhet të di diçka, pse e merr?

Prenga heshti një grimë, pastaj e shikoi Blertën me sy të egërsuar. Pëshpëriti mandej diçka nëpër buzët e tij të thara dhe foli i inatosur:

— Unë jam baba i saj. Qite!

Blerta e pa për një çast me habi malësorin. Çfarë kishte ngjarë? Ngriti supet dhe hyri në klasë. Pas një minute, doli së bashku me vajzën njëmbëdhjetëvjeçare të Prengës.

— Ja ku e ke, Prengë, — foli Blerta. — Megjithatë, unë dëshiroj që të mos ketë ndodhur asgjë e keqe. Vajza shkon mirë me mësime.

— Ani, ani. Tungjatjeta!

Mori për dore vajzën e hutuar dhe doli përjashta, pa thënë asnjë fjalë tjetër.

Mbetëm disa minuta të heshtura.

— Po ky?..., — murmuriti Blerta, duke më shikuar në sy.

Ngrita supet. Ç't'i thosha?

— Kushedi, pëshpërita unë. — Ndoshta ka ndonjë hall në shtëpi.

— Nuk ma ha mendja. Njeriu që ka hall në shtëpi, nuk sillet në këtë mënyrë. E pe se si më shikonte?

Dolëm te dera e jashtme e shkollës. Prenga me të bijën ishin drejtuar për nga shtëpia e Istrefit.

— Shkojmë, Blerta!, — i thashë.

— Çfarë ka ngjarë, xhanëm?, — foli Blerta, më shumë me vete sesa me mua.

— Sot pasdreke e sqarojmë, — u përpoqa të qetësoja veten dhe Blertën. Hyra në klasë. Pas meje hyri dhe ajo në klasën e saj.

#### IV

Përjashta, qelli kishte marrë përsëri atë ngjyrën e trishtë të plumbit të shkrirë, ndërsa toka, që ishte shkrimur disi në mëngjes, tanë qe ngurosur prapë e bërë kallkan. Toka priste dëborën e parë të atij viti.

Blerta ekte e menduar nëpër udhën tërë gurë të fshatit, që të çonte në dhomën tonë. Herë pas here sytë i hidhët nga lagjja e sipërme e fshatit. Atje e kishte shtëpinë Prengë Shtjefni. Ai Prengë, i cili papritmas dhe fare pa kujtar, e bëri këtë copë rrugë të mërzitshme. Ç'kishte vallë dhe përse u soll ashtu me Blertën? . . .

Në kushte të tjera, Blerta do të tregonte me kënaqësi diçka për nxënësit e saj të zgjuar, por tanë, fytyra e saj e ëmbël e kishte humbur atë gjallërinë e mëparshme. Që bërë e menduar dhe kohë pas kohe vrenjtej.

Nuk po e duroja dot heshtjen e saj. Hapat i hidhja ngadalë, si me pendim, sikur ta dija që atje, në dhomë, na priste një ngjarje tjetër, më e hidhur nga sjellja e ashpër e Prengës. Blerta e kishte varur paksa kokën mënjanë, ndërsa unë ecja pas saj, e paaftë të thosha ndonjë fjalë, e cila mund të zgjonte tek ajo interes.

Nëpër rrugë nuk dukej njeri. Ishte mesi i ditës dhe banorët e fshatit tashmë kishin lënë punën. Nga larg vin-

te tringëllima e mbytur e një këmbore, pastaj përsëri heshtje. Në të majtë, mbi shpatin e një shkëmbi të mbushur plot e përplot me shegë të egra, ca dhen përpinqeshin të arrinin degët e tyre.

Blerta ndali papritur dhe u kthyte nga unë.

— Nuk po më hiqet nga mendja Prenga, — tha gjithnjë e menduar ajo. — Ç'pat që u soll ashtu?

— As unë, nuk e kuptoj, — ngrita supet.

— Dëgjo, Vera!, — foli ajo me një zë, ku ndihej qartë këmbëngulja. — Unë po shkoj që tani në kullën e Prengës.

— Jo, Blerta! Prit. Nuk duhet të nxitohemi.

E thashë me qëllim këtë. Edhe unë kisha po atë mendim. Ardhja e Prengës nuk qe diçka e rastit. Fytyra e tij e ashpër, vështrimi i tij kërcënues e tregonin fare mirë këtë. Ai kishte diçka kundër Blertës ose kundër të dyjave. Por, megjithëkëtë, isha e mendimit që nuk duhej të nxitoheshim. Kushedi! Jetë i thonë kësaj. Njerëzit kanë hallet e tyre...

Ç'është e vërteta, këtë e bëja dhe për një arsyе tjetër. Nuk doja në asnje mënyrë që Blerta të shqetësohej më te-për. Unë nuk doja që për asnje çast të vritej, qoftë dhe pak, gëzimi i saj. Si të thuash, pa u ndier isha kthyer në roje të natyrës së saj aq të qeshur. Dhe këtë, ashtu në heshtje, mundohesha ta kryeja sa më mirë. Kurse përsa i përket punës së Prengës, ajo me siguri do të sqarohej shpejt, në mos atë pasdreke, ditën tjetër.

Blerta hyri në dhomë e mërzitur, ndërsa unë nisa të mendoja papritur për Sanijen. E kam parë gjithnjë me kë-naqësi praninë e saj në dhomën tonë, kurse tani e shikoja si një shpëtim nga ajo heshtje e mërzitshme. Ardhja e saj

do ta bënte patjetër Blertën të gëzuar dhe ajo mbasse do ta harronte për një farë kohe Prengë Shtjefnin.

Dhe vërtet kështu ndodhi. Pas një ore Sanija hyri në dhomën tonë.

Moti ishte zbutur, kurse qelli i trubullt dukej sikur kishte zbritur aq poshtë, sa të thoshte mendja se mund ta prekje me dorë.

Kisha ndezur zjarrin dhe muret e sobës ishin përflakur mirë. Dhoma qe bërë e ngrohtë. Sanija qëndronte e hesh-tur pranë tavolinës, ndërsa sytë ia hidhte herë Blertës e herë-herë buqetës me lule të kaltra artificiale, që ajo e kishte aq qejf.

Blerta dukej sikur e kishte harruar tashmë Prengën e zymtë. Ajo po preqatiste ditarin për të nesërmen dhe ende s'kishte filluar ai dialog i zakonshëm i cili kishte pothuaj gjithnjë të njëjtët partnerë: Nga njëra anë Blertën e gëzuar e të guximshme në mendime dhe nga ana tjeter, Sanjen e druajtur në fillim, por që pastaj gjallërohej e niste të cicërinte, si të mos ishte ajo e para.

Po shikoja përjashta. Një tufë fletëzash të bardha kris-talike u përplasën papandehur pas xhamave të dritäres so-në. Nisi të binte dëborë. Në fillim avash-avash, pastaj qelli i ngrirë zu të derdhte qindra e mijëra fletëza të tillë të bardha.

— Dëborë!, — thirri Blerta e gëzuar.

— Borë, — tha dhe Sanija e mërzitur.

Këtë mërsi në zërin e Sanijes, Blerta nuk e vuri re. E shikova në çast Sanjen. Ajo nuk i qëndroi gjatë vështri-mit tim dhe uli kokën. Dukej se nuk donte ta trazonin aspak. Ishte e shqetësuar. Kjo gjë më bëri përshtypje dhe desha t'i flisja, por atë çast Blerta thirri:

— E mahnitshme, Vera! Hajde, shikoni. Dëbora po shtron menjéherë. Ishte entuziazmuar tamam si një fëmijë.

— Dalim e luajmë përjashta, Sanije, — u kthyte nga ne Blerta dhe qeshi.

Sanija nuk foli. Sikur u tremb një çast, pastaj tundi kokën në shenjë mohimi. Kësaj radhe, Blerta e vuri re pamjen e pikëlluar të Sanijes dhe i shkoi pranë.

— Ç'ke Sanije? Je sëmurë?

— Jo zonjushë! Nuk kam asgja.

— Të kam thënë mos më thirr më zonjushë, — tha Blerta e lehtesar. — Unë jam shoqja yte. Mirë?

— Mirë, zonjushë!

— A, tani e prishe, Sanije. Po nejse. E lexove librin që të dhashë a? Sanija uli sérish kokën dhe atë çast u duk sikur u rrëqeth.

— Hë, e lexove?, — përsëriti pyetjen Blerta.

— Jo, zonjushë!

— Pse?! — tha Blerta e habitur. Ishte hera e parë që Sanija nuk plotësonte pikë për pikë detyrat e saj. Ajo ngriti kokën dhe e pa një sekondë në sy Blertën. Me fytyrën e saj të hequr, prej nga shihnin dy sy të bukur gështenjë, u dha në çast një hije shqetësimi. U skuq paksa, pastaj shikimin e hodhi përtëj dritares, atje ku ngríhej kulla e saj. Me këtë sikur deshi të thoshte: «Unë desha, zonjushë, por baba.... «Sytë iu njomën dhe dy pika lotë iu rrokullisën faqeve. Blerta dhe unë mbetëm disa sekonda të hutuara.

— Qetësohu, Sanije! Qetësohu! Pse qan?

— Baba nuk më la me e lexue librin, zonjushë!

— Nuk të la baba?!...

Në zërin e Blertës atë çast u ndie një notë mosbesimi. Istrefi, sido që të ishte, nuk e kishte penguar ndonjéherë

Sanijen tē lexonte librat që i kishte dhënë Blerta. Atëherë, ç'kishte ngjaçë pra?

— Po zonjushë! Nuk më la baba, — nxitoi e foli Sanija. — Bile unë kam ikë fshehtas nga nulla.

Nuk kishte më asnje dyshim. Këtu diçka kishte ndodhur dhe shfaqja e saj, pas ardhjes së Prengës në shkollë, po merrte e po jepte tani më hapur.

Sanija kishte ngritur sytë dhe po e vështronte ngultas mësuesen. Ishte skuqur e tëra në fytyrë, sikur ta kishte goditur dikush faqe tē gjithëve. Unë kujtova një sekondë atë pëllëmbën e gjerë me gishterinjtë e trashë tē Istrefit dhe papritur u rrëqetha.

— Unë nuk vij ma këtu, zonjushë!, — foli me zë tē këputur Sanija, gati tē shpërthente në dënesa.

— Si?!, — kërceu Blerta.

— Po, zonjushë! Nuk vij ma.

— Ç'flet kështu, moj motra ime e vogël? Pse?

Në zërin e Blertës u ndie një notë lutjeje dhe unë u habita për disa çaste. Mos vallë kjo ishte një dobësi tē cilën s'e kisha vënë re më parë? Jo. Ajo nuk donte nëasnje mënyrë ta humbte Sanijen. Veç kësaj, përsë?

— Baba nuk do që unë tē vij ma këtu. Ai...

Sanija deshi tē thoshte dhe diçka tjetër, po papritur u shkreh në vaj. Blerta shtangu. Vështrimi i saj pyeste, po unë nuk isha në gjendje ta ndihmoja. Nuk po kuptoja as gjë. Mos vallë tani po ngrente krye ai konservatorizmi i Istrefit? Po. Patjetër kështu duhej tē ishte. Kanuni vepronnte ende me peshën e tij shtypëse mbi mendjen dhe zemrën e atij njeriu tē urtë, por tē molepsur nga e kaluara. Megjithatë, Blertës, me sa shihej, nuk i mjaftonte kjo. Ajo kërkonte arsyen e vërtetë.

— Fol Sanije!, — tha Blerta. — Pse nuk do Istrefi tē vish këtu?

— Nuk do, zonjushë! Baba thotë se ti..., — ndërpreu një çast të folurën, pastaj sikur mori forca dhe vazhdoi:

— Baba thotë se ti je vajzë e keqe.

— Çfarë? Çfarë?

— Pse je vajzë e keqe ti, zonjushë?, — foli gati me inat po edhe me një farë keqardhjeje Sanija.

— Sanije!

Tani po bëhej e qartë disi sjellja jo e mirë e Istrefit. Iu shfaq si të thuash koka. Dikush duhej të kishte folur keq për Blertën. E vështrova në sy. Fytyra saj e ëmbël e kishte humbur krejtësisht atë shprehjen e mëparshme të qeshur, qe bërë e hutuar. Nga ky shkak ndjeva në gjoks një peshë të rëndë e të hidhur. Po edhe Sanija mbeti si e trullosur, siç duket nga ajo që tha. Me siguri as vetë ajo s'e dinte se përsë mësuesja e saj, shoqja e saj e mirë, ishte e keqe.

— Po kjo?, — ngriti supet dhe buzëqeshi hidhur Blerta. — Ç'do të thotë kjo?

— Ndoshta ka ndonjë keqkuptim, — belbëzova, pastaj iu drejtova Sanijes: — Kush të tha ty kështu?

— Baba, zonjushë!

— Po babës, kush i tha? Erdhi njeri te ju sot?

— Erdhi Prenga i lagjes së sipërme, zonjushë!

— Çfarë i tha Istrefit?

— Nuk e di. Mua dhe Marën na qitën përjashta.

Uli kokën dhe doli ngadalë nga dhoma. Blerta nuk bëri asnjë përcapje të ndalonte Sanijen. Kishte mbetur në mes të dhomës, e heshtur dhe e pafuqishme. E gjithë pamja e saj dukej vetëm sikur pyeste, sikur bëhej gati të thërriste «Përse?... Përse kështu? Ç'kam bërë unë që jam e keqe»... Po nuk foli asnjë fjalë. Ndërsa unë, pa ditur ç'të thosha, rrija si e ngrirë. Ajo sjellje e ashpër e Prengës dhe tani Sanija, ranë papandehur mbi ne, si një shi i ftohtë akull pas

një dite të bukur me diell. Blerta ishte vrenjtur në fytyrë dhe kushedi ç'mendonte. Sigurisht për Sanjen dhe fjalët e saj. Qenë të rënda ato fjalë. Të skuqej faqja nga ato se-pse, ju duhet ta kuptioni, veç të tjerave, ç'do të thotë kjo për një mësuese...

E para e theu heshtjen Blerta. Ajo u kujtua për Sanjen që iku, u shkund si nga një ëndërr e keqe, pastaj më shikoi drejt në sy.

— Kjo është e çuditshme, — tha ajo e inatosur. — Përse?

— Një dreq e merr vesh, — fola unë. Në këtë mes nuk besoj të jetë vetëm puna e librave.

— Po çfarë atëherë?, — ngriti zërin dhe tha me nxitim Blerta.

— Nuk e di, por... Ti e kuption, Blerta, që malësorët janë përgjithësisht fjalëpakë e të prerë në mendimet e tyre dhe nga kjo arsyё ndoshta s'para i kanë dhe aq në qejf vajzat e hedhura si ti. Kushedi ç'mendojnë.

E kuptova që e te prova ca me atë mendim të nxituar, por qe vonë.

— E kuptoj, — tha Blerta gati e dërrmuar. — Ata mendojnë keq për mua. Kjo duket sheshit.

Uli kokën dhe pas pak humbi në mendime. Më erdhi të haja veten me dhëmbë. Si guxova ta shprehja atë mendim të papeshuar? Si ta qetësoja shoqen? Çfarë t'i thosha? ... Në çast dhe fare pa kujtuar m'u përgas sërih njeriu i cili pat përgjuar në dritaren e dhomës sonë atë natë kur ishte Genci te ne. Pas një minute, mendimi që më shkrepit në kokë e përshkoi hijen e njeriut në dritare dhe ngjarjen e asaj dite me një fill të përbashkët. Me siguri ai njeri kishte folur andej-këtej. Gjuha e tij e neveritur... Jo. Mendimi i parë u zhavarit në çast. Përse flitej vetëm për Blertën? Në fillim Prenga dhe pastaj Sanija, vetëm

për Blertën kishin folur. Sipas tyre, ajo ishte... Dreqi c mori atë fjalë. Nuk mund ta shqiptoja. Po unë?... As Prenga dhe më vonë as Sanija nuk thanë gjë për mua. Përse? Pse vetëm për Blertën?!... Ky mendim më rrëmbeu dhe pas pak thashë me vete që me siguri, nëse këtu s'do të kishte ndonjë keqkuptim, patjetër që dikush ishte i interesuar ta shqetësonte Blertën, t'ia shuanë njëherë e përgjithnjë gëzimin. Ndryshe nuk mund të shpjegohej.

Po isha gabuar. Fjala nuk ishte as për Blertën dhe as për mua. Këtë e mora vesh më vonë. Goditja synonte tjetërkund. Ajo përpiquej të.... Nejse. Unë po tregoj me radhë ashtu siç ngjau.

Pra, njeriu që kishte përgjuar në dritaren e dhomës sonë atë natë kur ishte Genci, mbeti dhe për disa çaste të tjera i ngulitur në mendjen time. Kush kishte qenë vallë?

— Dikush ka shpifur, Blerta, — fola, tashmë me një farë sigurie.

— Kush?, — ngriti menjëherë, kokën ajo.

— Nuk e di, po për këtë që po them jam e bindur.

— Po të jetë kështu, atëherë unë po shkoj të bisedoj që tani me Istrefin, — tha ajo.

— Jo, jo. Në asnjë mënyrë tani, — i kundërshtova unë.

— Pse?

— Sepse Istrefi tani me siguri është i inatosur dhe në këto kushte zor se nxjerr gjë prej tij.

Kujtova Sanijen, pastaj Istrefin dhe heshta pa ditur ç'të thosha tjetër. Po Blerta nuk ia vuri veshin kundërshtimit tim. Veshi shpejt e shpejt pallton e saj ngjyrë vishnje dhe doli përjashta.

Kishte zënë të binte mbrëmja. Trupi i plotë e i zhdërvjellët i Blertës u end për një copë herë mbi shtrojen e

bardhë të dëborës, pastaj humbi përmes degëve të zbar-dhura të mollëve.

Blera u kthye shpejt në dhomë. Buzëqeshi një çast hidhur, aty te praku i derës, pastaj shkoi pranë tavolinës dhe ia mbërtheu vështrimin buqetës me lule të kaltra artificiale. Nuk foli asnje fjalë, çdo gjë u mor vesh në heshtje. Në sytë e saj të ndezur kishte revoltë dhe njëko-hësisht përpjekje për të mësuar të vërtetën. Ç'kishte ngjarë? Pse Prengë Shtjefni qe sjellur në atë mënyrë? Përse Sanija kishte thënë ato fjalë: «Pse je vajzë e keqe ti, zo-njushë?». Më mirë t'i kishte ndodhur një fatkeqësi çfarë-do...

Nga kjo arsyе dukej e pikëlluar, por e gatshme në të njëjtën kohë të hidhej kudo, mjaft që ato fjalë të mos përmendeshin më, të shuheshin nga faqja e dheut njëherë e përgjithmonë. Prenga e kishte prekur në sedër si mësuese të vajzës së tij, kurse Sanija e kishte vrarë si njeri. E kishte lënduar në zemër.

— E takove Istrefin?, — pyeta unë pas pak.

— Jo, — tha Blera, — nuk doli fare.

— Si?... Je e sigurtë që ai ishte në kullë?, — fola, duke mos i besuar dhe aq kësaj.

— Po.

— Edhe Sanija ishte?

— Mua më duhet Istrefi, — tha Blera e inatosur.

— Mos u inatos, Blera. Ndoshta është më mirë që ndodhi kështu. Nesër, Istrefi mbase do të qetësohet dhe ne mund të bisedojmë shtruar me të.

— Ia kam frikën atij njeriu, — pëshpëriti Blera. — Ai di vetëm të kyçë gojën.

— Atëherë shkojmë e bisedojmë me sekretarin e Partisë.

— Çfarë?

Ajo ngriti përnjëherë kokën dhe për herë të parë e pashë të skuqur krejtësisht nga turpi.

— Bisedojmë me Gjokën!, — përsërita unë.

— Më asnje mënyrë, — kundërshtoi Blerta. — Për një gjë kaq të vogël të shkoj tek ai? E çfarë t'i them? Që Sanija erdhi në dhomë dhe më tha që unë jam vajzë e keqe, me një fjalë vajzë e përdalur dhe se i ati nuk e lë më të rrijë me mua, nga frika se mos e prish dhe atë. Për këto t'i them?...

— Nuk është pak kjo, Blerta, — thashë unë, duke kujtuar dhe Prengën, i cili erdhi në shkollë dhe në mënyrë jo të zakontë mori vajzën e tij.

— Nuk shkoj tek ai, jo, — kundërshtoi përfundimisht Blerta. — Ai ka boll telashet e veta tani. Kooperativa... Pastaj unë jam mësuese, dreqi e mori! Me ç'sy e faqe do të shkoj tek ai për një gjë të cilën mund ta zgjidh dhe vetë?

Foli gjithë zjarr dhe e inatosur. Pas një minute ndjeva që ajo kishte të drejtë dhe heshta. Po kjo heشتje qe e shkurtër, sepse menjëherë mes Blertës dhe meje hyri përsëri njeriu që kishte përgjuar atë natë kur te ne qe Genci. Dhe fola:

— Dëgjo Blerta! Puna nuk është aq e thjeshtë sa të duket.

— Po si?

— Ty të kujtohet besoj ajo natë kur një njeri përgjoi në dritaren tonë.

— Patjetër, dhe pastaj?

— Kjo ngjarje ka lidhje me atë njeri. Për këtë jam e bindur.

— Përralla! Po të ishte ashtu, pse ta kishin vetëm me mua?

— Sepse dikujt i intereson vetëm ti.

Blerta heshti e hutuar. Atë kohë unë nuk e dija ende

që ajo ngjarje rëndonte dhe mbi mua. Mbase ngaqçë kundrejt meje nuk po mbahej ende ndonjë qëndrim i dukshëm. Sidoqoftë, deri atë çast unë mendoj se dikush interesohej vetëm për Blertën.

— Domethënë fjala është për Gencin, — theu heshtjen Blerta, ndërsa balli iu rrudh e u bë gati të shpërthente.

— Po. Me siguri, — thashë unë. — Pasi iku Genci, të nesërmen erdhi Prenga dhe pastaj Sanija.

— Kjo është e tmerrshme, — shfryu me inat Blerta. — Ne vetëm sa kënduam.

— Mos u mërzit, motra ime, — u mundova ta qetësoja Blertën. — Ti je e mirë, e mrekullueshme, unë të njoh ty. Por jam e bindur për këto që të fola, sepse atë njeri e kam parë dhe njëherë tjetër në dritaren tonë.

— Dhe nuk e njeh përsëri?

— Jo.

— Megjithatë, kjo është për të qeshur, — foli Blerta.

— Në dhomë, në të dy rastet nuk kemi qenë vetëm ne të dy me Gencin ke qenë edhe ti.

— Pikërisht për këtë duhet të shkojmë te sekretari i Partisë. Çështja është për punën. Pastaj, ti e kupton që këto fjalë, veç të tjerave, janë tepër të rënda për një mësuese.

Kafshova buzën. Blerta u trondit shumë nga ai mendim që shpreha dhe uli kokën e dërrmuar. Ishte çasti i parë që po e shihja ashtu, si e dorëzuar. Isha mësuar ta shikojja gjithnjë të gëzuar, të fortë e të guximshme dhe ç'është e vërteta atë çast nuk më erdhi mirë.

— Hë pra, — i thashë, — shkojmë bashkë nesër?

— Të thashë një herë që nuk shkoj te Gjoka. Pa biseduar vetë me Istrefin dhe me Prengën, nuk shkoj.

— Mos ngul këmbë kot, Blerta!

Ajo heshti e nuk foli më. Përjashta qe errur fare dhe

nuk shquheshin më flokët e dëborës që binin qetë-qetë mbi tokën e zbardhur.

Dera e dhomës trokiti papritmas. Kush ishte vallë? Në atë orë zakonisht, me përjashtim të Gencit, nuk vinte po-thuaj njeri në dhomën tonë. Por e trokitura nuk i ngjante asaj të Gencit. U shqetësuam. Blerta më pa në sy dhe nuk foli. Trokitja u përsërit. Qe një trokitje e rrallë, e ulët dhe e vrazhdë njëkohësisht.

— Hyrë! — fola unë pa luajtur nga vendi.

Dera u hap ngadalë dhe në dhomë hyri Istrefi. Ishte hera e parë që kalonte prakun e derës sonë. Në fytyrën e tij të gjerë, ku spikaste mjekra katrore, e zbardhur, kish-te atë çast një shprehje kërcënimi. Ai qëndroi në këmbë dhe na vështroi një copë herë në sy si me dyshim dhe si-kur kërkonte në heshtje të mësonte diçka që nuk e dinte ende mirë. Pastaj foli:

— Mirëmbrama! Ndoshta nuk asht koha, por erdha. . .

Mezi i nxori ato fjalë. Ishte i mërzitur.

— Ulu, xha Istref!, — fola menjëherë, duke i afruar karrigen pranë sobës.

— Të falem nderit, nuk ulem, — tha ai, ndërsa sytë ia mbërtheu Blertës. — Nuk desha të vija po të pashë që erdhe parë te kulla ime dhe thashë të të them nja dy fjalë.

— Fol, xha Istref!, — tha Blerta. — Unë për atë punë erdha. Të bisedoj më ty.

— Atëherë, bukur fort, — ngriti zërin ai. — Në kullën time s'ke ma punë, oj ti mësuese.

— Xha Istref!, — thirri Blerta, thua se dikush e goditi atë çast me pëllëmbë fytyrës. — Po më rëndon pa të drejtë.

— Kështu si po të them, oj mësuese. Kulla ime asht vërtet e vjetër dhe e varfër, por njerëzit brenda i ka mbajtë gjithmonë me faqe të bardhë.

— E di, xha Istref, prandaj dhe Sanjen e kam dashur

dhe e dua tamam si motrën time të vogël. Po ty të kanë gënjer, të kanë mashtruar dhe nuk e di pse. Mendoje mire këtë punë, xha Istref!

— Nuk më duhet gja ma tepër mue.

— Por mos i beso gojës së tjetrit pa i pasur sytë në ballë, xha Istref. Dikush ka shpifur.

Në fytyrën e Istrefit luajti në çast një muskul. Lëvizzi një çast këmbët, si t'i qenë mpirë aty ku i kishte ngulur, pastaj zgjati dorën e madhe përpëra.

— Urdhëno pra librin, — foli me zë të ashpër. — Mue nuk më duhen në shtëpi libra të tillë. Mbajini përvete. Jemi mirë kështu si jemi dhe pa ta dhe, ndigjo këtu, oj mësuese! Herë të tjetra mos m'i bini ma në qafë Sanijes. Jeni si jeni ju, punë për ju. Hajt, tungjatjeta!

— Xha Istref! E ke gabim, xha Istref! Qëndro të merremi vesh.

— S'kemi për se të merremi vesh. Tungjatjeta!

Tha këto fjalë, pastaj doli përjashta, i zymtë e i ashpër si një shkëmb. Blerta mbeti në këmbë, sërisht e shtangur. Fytyra e saj e kishte humbur tani gjithë hijeshinë dhe ngjante sikur dikush i kishte pëshpëritur në vesh ndonjë fjalë tepër të çuditshme.

— Edhe ky..., — tha pastaj pa mundur të shtonte as gjë më shumë. Heshta. Nuk kisha dëshirë të flisja asnjë fjalë. Në kraharor ndjeva të më shtrëngonte një si darë, ndërsa në grykë zu të ngjitej një lëmsh i bezdisshëm. «Hej, ta marrë dreqi, ta marrë, — mezi belbëzova. — Si po rrokulliset ngjarja kështu?».

Kisha përsëri ftohtë. Istrefi kishte lënë prapa një shkulm erërash të akullta që me rrëqethën gjithë trupin. Po edhe Blerta s'kishte ndër mend të fliste. E panjohura që në fillim u shpreh me qëndrimin e Prengës, më vonë të Sanijes dhe tani me Istrefin, nuk kishte sy tjetër veç atij të një keqdashësi i cili kishte përshpëritur andej-këtej

duke trubulluar mendjen e këtyre njerëzve të ndershëm.

Blera shkoi pranë tavolinës dhe i hodhi një sy librit, të cilin ia kishte dhënë Sanijes tri ditë më parë dhe që Istrefi e solli me vete dhe e hodhi mbi tavolinë. Dy duar të ashpra e kishin grisur atë në dy-tri vende. Me siguri duart e Istrefit.

## V

Ngjarja e asaj dite, që Sanijen dhe Istrefin, nuk duhej të kishte përfunduar me aq. Kështu e mendoja unë, ndoshët ngaqë nuk isha mësuar me gjëra të tilla dhe, natyrisht, u jepja më tepër rëndësi nga ç'duhej, ose sepse vetë heshtja e Blertës i linte fushë të lirë këtij mendimi. Cili do të ishte fundi? Nuk e fsheh, unë e përfytyroja atë edhe më të ash-për nga sa u shfaq atë pasdreke. Po për këtë nuk i flisja Blertës. Me imaginatën time bridhja, e ku nuk bridhja për të gjetur «gjuhën» që ishte shkaku i asaj kthese të menjë-hershme, ndërsa njeriu në dritare (unë tashmë isha plotësisht e bindur që ai kishte përgjuar me qëllim atë natë dhe nuk mund të ishte kurrsesi kalimtar i rastit apo dhe ndonjë kureshtar), më përqasej herë pas here, në forma nga më të ndryshmet. Gjuha e tij e vjetër afrohej në imaginatën time me përmasat e çuditshme të një sharre të ndryshkur, e cila porsa kishte rënë mbi lastarin e njomë të gëzimit, duke lëshuar ca gërvima rrëqethëse. A thua do ta pris-te deri në fund këtë lastar?... Ishte e pamundur kjo, po megjithatë, unë ia kisha frikën.

Kishim rënë të flnim. Nata e qetë zvarisej ngadalë, tmerësisht e gjatë. Blera kthehej herë pas here sa në njërin

krah në tjetrit dhe nuk fliste. Unë dëgjoja frysëmarrjen e saj të thellë dhe çuditesha me heshtjen e shoqes.

- Nuk ke fjetur ende, Blerta?, — e pyeta në errësirë.
- Jo, u përgjigj ajo. — Nuk kam gjumë.
- Përpiqu të flesh, — pëshpërita.
- Po ti?
- Edhe unë.

U ktheva në krahun tjetër dhe heshta. Nuk doja t'i thosha që atë natë s'kishte ndër mend të më zinte fare gjumi. Kjo mbasë do ta shqetësonë dhe më. Dhe pa ditur ç'të bëja, vështroja në dritare. Çudi. Tani nuk ndieja asnjë shqetësim nga imazhi i trubullt i atij njeriut që kishte përgjuar në dritaren e dhomës. Përkundrazi. Pëshpëritja e gjuhës së tij, si një erë e ftohtë dhe e hallakatur, më sillte guximin, i cili vinte me siguri nga revolta kundër saj. Por nuk dukej asgjë. Ishte zhdukur. Ku e kishte ndalur tani vrapin vallë? Ng ç'vatër të ndershme po shfrynte bulçitë e tij të neveritur?

Nata nuk po shtyhej dhe unë zura të mos e duroja më atë napën e saj të errët e të mërzitshme. Le të vinte dita. Sa më parë le të vinte. Ndoshëta ajo do të jepte diçka më shumë e më qartë, sesa ajo pasdreke e zymtë dimri.

— Vera!, — foli Blerta papritur. — Nuk ke gjumë as ti?

- Jo, kam, — gënjeva unë. — Pse?
- Më thuaj të drejtën, ke?
- Jo, Blerta, — u detyrova të pohoja të vërtetën.
- Atëherë mirë. Hajde të bisedojmë.
- Mirë. Bisedojmë.
- Ta ndez dritën?, — tha Blerta.
- Ndoshëta s'është nevoja, — thashë unë.
- E di çfarë po mendoja, Vera!, — nisi të fliste Blerta. — Pse u kujtua ai njeri të shpifë pikërisht tani?

Në qoftë se është fjala për Gencin, ai ka ardhur kushti  
di sa herë në dhomën tonë. Pse tani?

— Sepse tani mbashi iu mbush mendja, — thashë  
unë.

— Jo. Këtu ka diçka tjetër mendoj unë.

— Çfarë?

— Kam frikë se fjala është më shumë për kooperati-  
vën.

— Kooperativën?! Ç'hyn këtu kooperativa?

— Po ja. Ti e di që së shpejti këtu krijohet kooperativa e parë e zonës. Dikujt kjo nuk i intereson dhe, duke e ditur që ne kemi bërë e bëjmë diçka për të, nga ana tjetër duke shfrytëzuar nderin, që është pika më e fortë e në të njëjtën kohë edhe më e dobët e malësorit, hap fjalë të tilla si këto për mua, të cilat ia trubullojnë mendjen atij dhe e bëjnë, në fund të fundit, të heqë ndoshta dhe dorë nga kooperativa. Shkurt, siç thonë vetë malësorët, për një punë të majme ta falë me gjithë qejf një zog.

— Po të jetë puna kështu, — fola pas pak unë, — atë-  
herë duhet medoemos dhe sa më parë të bisedojmë me se-  
kretarin e Partisë.

— Ah, jo, Vera. Vetëm mendimi që ai do ta marrë vesh  
këtë më skuq faqen. Nuk arrij të kuptoj se si mund t'i dal  
përrpara.

— Mos u bëj budallaqe. Ti je krejtësisht e pastër.

— E di, Vera, e di. Sekretari nuk do të dyshojë tek  
unë, po prapëseprapë se si më duket. Më vjen turp, qof-  
të dhe për ato fjalë të rreme që janë përhapur.

— Megjithatë, ne duhet të bisedojmë qysh 'nesër me  
Gjokën.

— Jo, jo, — kundërshtoi përsëri Blerta. — Nuk më  
pëlqen kështu. Unë do ta zgjidh vetë këtë punë.

Heshti për disa minuta. Në zërin e saj ndihej qartë  
tani qetësia dhe besimi në vete. Ajo po e rimerre veten  
shpejt.

Mëngjesi erdhi ngadalë, i ftohtë e i bardhë. Mes një heshtjeje të thellë që dukej sikur s'do të kishte mbarim kurrë, flokët e mëdhenj të dëborës binin butë-butë, me një ngadalësi të habitshme. Gëzofi i trashë i dëborës ndris-te me reflekse të zbeta.

Blera nxitoi hatap, pastaj u kthye papritur. Më daroviti me një top dëbore, që u thërrmua në çast në supin tim të djathtë. Buzëqesha. Atë mëngjes ajo ndihej çuditërisht e qetë. Veçse nën dy sytë e saj të mëdhenj ishin formuar dy rrathë të lehtë mavi, që i jepnin fytyrës një pamje të lodhur. Sidoqoftë, ajo qetësia e saj, gjëzimi që çeli papritur në buzët/e saja të fryra e të kuqe si qershi, më dhanë kurajë. Hej, ç'njeri që ishte ajo. Pa e kuptuar se si, isha vënë plotësisht nën ndikimin e karakterit të saj të mrekullueshëm. Një karakter sanguin ose, siç thoshte ajo vetë nganjëherë me të qeshur, «Një karakter ala sanguin, kolerik, diçka e trazuar për bukurin».

Shkonim për në shkollë. Përjashta, në rrugë, dukeshin gjurmë të vogla, që dëbora po i mbulonte avash-avash. Po nuk dukej njeri. Tutje, nga lagjja e sipërme e fshatit vinte një angullimë e trishtë qeni. Moti zu të zbutej.

Blera i hodhi sytë një çast nga kulla e Istrefit. E heshtur dhe me dritaret e vogla të myllura, ajo ngjante mes bardhësisë së dëborës si një dhëmb i stërmadh, i krimbur.

— Vera!, — thirri papritur Blera. — E pe Sanijen?

— Jo. Ku?

— Në dritaren e anës. Zgjati një çast kokën dhe na shikoi.

— Me gjithë mend?

— Po.

Ajo e ka shumë të vështirë, Blera! Bile më vështirë sesa ne ndoshta, — fola e menduar duke kujtar Istrefin.

— Ashtu është, — shtoi ajo e mërzitur. — Më vjen aq

keq për të, sa nuk ta merr mendja. Si ngjau kjo punë kësh-tu?

Nuk i dhashë përgjigje. Përpara nesh, në rrugë, u dha Ndoi, një fshatar rrëth të dyzetave, me një bohçe në duar dhe që e cte duke anuar paksa nga e djathta. Xhaketën prej kadifeje e mbante zbërthyer dhe ashtu, i qeshur qhe me shaminë hedhur në qafë, dukej sikur po nxitonte diku për në festë.

— Mirëmëngjesi!, — përshëndeti ai dy-tre hapa përpara.

— Mirëmëngjesi, Ndoi! Për ku rruga e bardhë kështu?, — buzëqeshi Blerta duke u munduar të fliste në dialektin e malësorëve.

— Askurkund, oj mësuese, veç isha pak në shkollë e s'ju gjeta. Njitash apo u ktheva prej lokalitetit.

— Pse?, — pyeta gati me gjak të ngrirë, se m'u kujtua ngjarja me Prengën dhe Istrefin. Dinte gjë Ndoi vallë?

— Sot kam gjësim në shtëpi, oj mësuese, dhe qejfi ma do që ju të urdhënoni mbasditë në kullën time. Dila shkon nesër në Shkodër, në kursin tremujor të grues, e unë isha në lokalitet me i ble një rubë të re dhe do gjana të tjera të vogla që i duhen. A vini pra?

— Patjetër, Ndoi!, — tha Blerta.

— E pra mirë se të vini! Dila ju pret.

Buzëqeshi dhe, pasi na shtrëngoi duart, u largua. Unë solla në mend Dilën. Ajo ishte gruaja e Ndoit. Para katër vjetësh kishe qenë një nga të parat aksioniste të fshatit në ndërtimin e hekurudhës dhe tanë po zbriste sërisht në qytet, por kësaj radhe me një detyrë tjetër, po aq të bukur sa dhe e para.

Blerta qe çelur në fytyrë dhe pa folur nxitoi hapat. Në oborrin e shkollës ishin grumbulluar nxënësit. Shaba u duk një çast tek dera e jashtme, i foli diçka një fëmije, pastaj hyri brenda.

— Paska ardhur Shaba, — thashë unë.

— Shaba?! Po ai ishte sëmurë?, — foli Blerta.

Nuk e di pse, ky njeri s'para më pëlqente. C'është e vërteta, interesimi i tij i herëpashershëm për ne, për shkollën dhe për fëmijët nuk ishte i imponuar dhe as paguhej. Kështu pra, ai e bënte këtë me një dëshirë të heshtur, po mua pikërisht kjo sepse s'më pëlqente. Të ishte kaq i ndërgjegjshëm ky njeri? Vështrimi i tij nganjëherë tinzar nuk e tregonte këtë. Megjithatë, nuk dua t'i bie në qafë. Mbase e bënte këtë me sinqeritet, sepse në vatrën e tij nuk gjëzoi kurrë fëmijë, shtëpinë e kishte pranë shkollës dhe ndoshta kështu kryente një shërbim të mirë për fëmijët e bashkëfshatarëve të vet. Shërbyesi pa rrogë i shkollës sonë ishte njeri interesant. Njëherë më kërkoi një vërtetim për drutë që sillte në shkollë. «Përse e do, Shabë», e pyeta. «Kot, oj zojushë, kot. Veç ta kem në xhep.» Që atëherë zu të mos më pëlqente. C'i duhej vërtetimi?...

— Mirëmëngjesi zonjushë!

— Mirëmëngjesi zonjushë!

Përshëndetja e njohur bëri që ne të harronim çdo gjë tjetër që s'kishte lidhje me nxënësit. Në pragun e derës doli Shaba.

— Mirëmëngjesi Shabë!, — qeshi Blerta. — Paske ardhur?

— Erdha, oj zojushë! Po ju si fjetët? Mirë?, — tregoi dhëmbët e zverdhur Shaba.

— Mirë, të falemi nderit, — tha Blerta. — Po ti?

— Dje isha pak sëmunë. Gja pa qeder.

— Të shkuara atëherë, — foli përsëri Blerta dhe hyri në klasë. Pas pak, ajo erdhi tek unë e shqetësuar. U hodhi një sy nxënësve, pastaj foli:

— Mungojnë katër nxënës, — tha e menduar.

— Edhe tek unë mungojnë dy, — i thashë.

— Thua të jetë e rastit kjo, Vera?, — pyeti ajo.

— Nuk di çfarë të them iu përgjigja duke ngritur sumpat.

— Ç'është e vërteta nxënësit vinin rregullisht në shkolle dhe tani këto mungesa bënë përshtypje të keqe. Ndoshëta ngaqë ne e shihnim me dyshim këtë gjë, me mendjen te ngjarja e djeshme ose, ku ta dish, mbapse ata mungonin dhe nga kjo dëborë e dendur. Por jo. Nuk duhej të ishte kjo e fundit.

— I pyete përse mungojnë?, — foja unë.

— Po. Nuk dinë asgjë.

— Po vajza e Prengës erdhi?

— Jo, — tha Blerta.

— Mirë atëherë, — thashë, — vazhdo mësimin, Blerta. Pasdreke shkojmë e interesohemi.

Blerta doli e heshtur dhe nga jashtë erdhi zëri i Shabës që pyeste:

— A ju duhem gjia, zojushë?

— Të falemi nderit, Shabë!, — tha Blerta.

— A mungojnë shumë fëmijë, a?, — pyeti sërish zëri i Shabës.

— Po, Shabë. Mungojnë gjashtë fëmijë.

— Ndoshta prej dëborës, oj zojushë! Ka ra shumë. A të shkoj e të shof njëherë pér ta?

— Jo, Shabë, jo. Nuk bën. Shkojmë ne.

— Ani mirë...

Shaba foli dhe diçka tjetër, pastaj heshti. Nga klasa tjetër erdhi zëri i Blertës. Kishte filluar mësimi.

Ato katër orë mësimi u dukën tepër të gjata e të mërzitshme. Ishte hera e parë ndoshta që ne, kundër dëshirës sonë, kërkonim që kjo kohë të kalonte sa më shpejt, të fluturonte. Por akrepat e orës, kokëfortë, lëviznin tepër ngadalë. Blerta vinte herë pas here të pyeste pér orën, ndërsa nxënësit, sikur ta kuptonin gjendjen e papëlqyesh-

me të mësueseve të tyre, ishin tkurrur dhe qëndronin si të hutuar. Dinin gjë vallë ata? Vetëm mendimi se ata fëmijë të zgjuar e të urtë mund të dinin diçka, ose fundja, mund të mësonin më vonë, qe i rëndë, tepër i rëndë për një mësuese. Po kjo, sipas Blertës, nuk kishte dhe aq rëndësi para mungesës së tyre. Mësuesi pa nxënës i ngjan një komandanti i cili, ndonëse i ka menduar me hollësi të gjitha rrëthanat e luftimit, prapëseprapë dhe fare papritmas mbetet pa ushtarë. A vazhdohet në këto kushte lufta vallë? Po. Edhe i vetëm...

Më në fund mësimi mbaroi dhe ne u nisëm. Dëbora kishte pushuar paksa dhe para syve tanë shfaqeshin tani quartë konturet e kullave, oxhakët e të cilave shkrofëtin pareshtur tym. Ato fjolla të murrëtyera tymi që ngjiteshin lart si me përtesë, ngjanin si një detaj i huaj e i panevojshëm në kartolinën e bardhë të fshatit.

Disa hapa pas shtëpisë së Shabës, rruga ngjitej në-për një kodër të thyer, mbi krepat e së cilës ngriheshin një këtu një atje, kullat. Më tutje, pas koriges, në faqen e pjerrët të kodrës, shtrihej lagjja e sipërme e fshatit. Atje duhej të shkonim. Nxënësit që mungonin ishin pothuaj të gjithë nga ajo lagje.

Blerta ecte në krye dhe nuk fliste. Dukej që nxitonë të arrinte sa më parë në lagjen e sipërme. Unë dëgjoja frymëmarjen e saj të thellë dhe shkelja e menduar në gjurmët që linte ajo pas. Dëbora vinte gjer në gju.

Papritmas, në dritaren e kullës së Ndoit u duk koka e një gruaje që buzëqeshte. Ishte Dila. Ajo hapi dritaren e vogël gati sa një frëngji dhe u mat të fliste; ndërkokë te dera e kullës doli Ndoi që thirri i gjëzuar:

— Eh, sa mirë batë që erdhët. Dila po ju pret.

Ndoi ishte njeri babaxhan dhe qe i njohur në fshat për mikpritjen e tij. Ishte blegtori i mirë, po nuk mbetej prapa dhe si bujk. Unë kisha dëgjuar njëherë Gjokën të thosh-

te se kooperativa e re nuk gjente kryetar më të mirë se Ndoin. Nejse. Ai hapi portën e vogël të lesës dhe u afrau me krahët të shtrirë pezull në hapësirë.

— Mirëdita Ndoi!, — tha Blerta, me një fije buzëqeshje në fytyrë.

— Mirëdita e mirë se erdhët! Hajdeni!

— Të falemi nderit. Nuk kemi kohë tani.

— E pse?, — tha disi i prerë në fytyrë ai.

— Sot kanë munguar disa nxënës nga lagjja e sipërme dhe po shkojmë t'i shohim njëherë.

— Boll mirë po bani, besa. Ishte dhe Gjoka.

— Gjoka??

Ta kishte marrë vesh edhe ai punën? Blerta, porsa dëgjoi emrin e tij, u skuq në fytyrë, pastaj uli kokën. Ndoi foli:

— Dhelpra vret gjithnjë hollë, oj ti mësuese.

— Ndoi!, — ngriti zërin Blerta, — ç'do të thuash me këtë?

— Ani, ani. Gjuetari i mirë veç, vret ma hollë se dhelpra. Puna asht me ia zanë mirë shtegun.

Ndoi nuk sqaroi më gjatë. Ai buzëqeshi një grimë, pastaj shtoi:

— Apo urdhënoni pra?

— Po vijmë më vonë, Ndoi!, — tha Blerta. — Të falemi nderit!

— Mirë ardhshi atëherë! Po ju presim.

Pritja dhe përcjellja e singertë e Ndoit na e ngrohën zemrën dhe pas pak e ndiem veten disi të lehtësuara. Ish-te më se e qartë: Gjuha e vjetër dhe e hallakatur kishte shfryrë bulçitë e saj të neveritur vetëm në disa nga vratat e malësorëve. Dhe këto ishin pikërisht ato, fëmijët e të cilave mungonin. Veç kësaj, nuk ishte thjesht një marrje nëpër gojë. Ndoi la të kuptohej se ishte diçka më shumë se shpifje. Unë kujtova në çast dyshimin e Blertës për

kooperativën, pastaj solla në mend sekretarin e Partisë. Ai e kishte kapur shpejt e shpejt situatën e krijuar dhe kishte shkuar vetë në shtëpinë e lagjes së sipërme. A ishte e domosdoshme të shkonim dhe ne pikërisht sot? Mbase nuk kam të drejtë, por unë mendoja që jo, kurse Blerta kundërshtonte.

— Kthehem Blerta!, — fola unë. — Përderisa ka shkuar sekretari i Partisë, ne s'kemi pse të shkojmë.

— Jo, — tha Blerta duke ecur. — Sekretari ka punën e tij, ne kemi tonën.

— Po ne s'kemi ndonjë gjë të re për t'u thënë.

— Ku e di ti se çfarë ka biseduar me ta sekretari, — ktheu kokën ajo.

— Ndoi e tha qartë këtë.

— Çfarë tha Ndoi?

— Nuk e dëgjove? «Njerëzit vrasin hollë», — tha ai, — dhe kjo do të thotë se fjala nuk është vetëm për ne.

— Atëherë puna është më keq, — tha ajo. — Ne duhet të shkojmë patjetër.

— Dëgjo, Blerta! Në qoftë se ata nuk e kanë besuar sekretarin, ne s'kanë pér të na besuar kurrë. Ata me siguri janë trubulluar tani dhe me praninë tonë ka rrezik të prishim më shumë punë sesa të ndreqim.

Blerta ndali dhe më vështroi një copë herë në sy. Siç dukej mendimi im e bindi.

— Takojmë njëherë Gjokën, pastaj mund të shkojmë, — shtova unë menjëherë.

— E ku ta gjejmë tani Gjokën?

— Këtej rrötull duhet të jetë.

Blerta uli kokën dhe qëndroi për disa çaste e menduar. Pamja e saj sikur thoshte: «E di, Vera! Më vjen aq rëndë nga Gjoka... Po megjithatë mirë. Bisedojmë njëherë me të».

U kthyem.

Për fat, pas një çerek ore sekretarin e Partisë e pamë tek po dilte nga pylli i vogël i shegëve, aty pranë kullës së Nikë Pjetrit. Ishte vetëm, i mërzitur dhe sigurisht, nga ky shkak, nuk na vuri re në fillim. Duart e mëdha të lëshuara poshtë i tundte fort, shenjë që tregonte se qe inatosur. Kështu ishte ai ngandonjëherë, gjaknxehëtë, kur punët nuk shkonin mirë dhe, ajo që binte në sy në kësi rastesh, çuditërisht i merrej paksa goja. Ndërsa fytyra e tij e gjerë, me një quk në mjekër, murrëtohej e bëhej disi e pakuptueshme.

— Mirëdita, shoku Gjokë!, — tha Blerta me gjysmë zëri.

Sekretari u kthye në çast dhe u përpoq të buzëqeshte.

— Ah, qenkeni ju. Më falni, nuk ju vura re. Po ju këtej?

— Sot kanë munguar disa nxënës në shkollë dhe...

— E di, e di, — e ndërpren ai Blertën. — Kanë munguar. Punët nuk po shkojnë aq mirë. Por...

Heshti papritmas. Fytyra i mori përsëri një shprehje të menduar, kurse pas pak vetullat iu kërleshën. Blerta dhe unë u rrëqethëm.

— Duan të sabotojnë kooperativën... Nejse, — e ktheu fjalën ai. — A shkuat në lagjen e sipërmë?

— Jo, thashë unë. Ndoi na tregoi që keni qenë ju më parë dhe ne thamë të bisedonim njëherë bashkë, pastaj...

— Keni bërë gabim, — tha ai shkurt. — Duhet të shkoni patjetër.

— Shkojmë tani, — foli menjëherë Blerta. — Për atje jemi nisur. Gjoka u mendua një copë herë, pastaj ngriti kokën dhe buzëqeshi lehtë.

— Mirë, mirë. Jo tashti. Shkoni më vonë.

Tha këto fjalë, pastaj nisi të ecte. Dukej që këmbëngulja e Blertës i pëlqeu. Fytyra iu çel dhe për një sekondë e vështroi Blertën në sy.

— Shoku Gjokë!, — tha Blerta. — Ju besoj duhet të jeni i bindur... Nuk mundi të vazhdonte më tej. Fytyra iu bë flakë e kuqe nga turpi dhe heshti.

— E di, e di, — ngriti zërin sekretari, sikur atë çast po i kanosej dikujt që mungonte aty dhe që kishte sjellë atë shqetësim. — Fshati i njeh mirë mësueset e tij, prandaj mos u bëni hiç merak. Vazhdoni punën. Së shpejti do të sqarohet çdo gjë.

Ecëm një copë herë në heshtje. Blerta u gjallërua në çast nga ai besim që sekretari shprehu ndaj saj në emër të fshatit dhe nisi ta çante déborën e trashë me një lehtësi të habitshme. Po sekretari i Partisë u mërzit sérish. Ndoshta nga ajo bisedë e papëlqyeshme, ose, ku ta dish, mbasë nga që ishte i detyruar tanë të spostohej disi dhe të merrej me një çështje e cila s'para i pëlgente. Drëdhitë nuk ishin natyrë e tij. E mundonin. Ai ishte nga ata burra që luftonte ballë për ballë.

Pa kuptuar, ai kishte marrë përpara me nxitim, duke harruar për një çast që ne ishim pas tij. Duart e mëdha e të gjata zu t'i tundte përsëri fort dhe ashtu ngjante sikur kërkonte të rrakte me to dikë. Ky gjest i tij shprehte fare qartë mllef, një inat që ia kishte trazuar keq zemrën. Pamja e tij ato çaste të ngallte besim që do ta bënte këtë përnjëherë dhe pa pikën e mëshirës, mjaft që ai njeri, i cili kishte shkaktuar gjithë këtë pështjellim, të shfaqej qartë para tij. Në një farë vendi u ndal papritur. Sérish buzëgeshi lehtë.

— Dëgjoni, vec!, — tha ai. — Malësorët janë njerëz të mirë, paçka se ka ndonjë tek-tuk që kërkon t'i trubullojë ujërat. Dhe di kur e ku t'i trubullojë.

Zëri i tij u bë në çast i butë. Heshti pak, pastaj shtoi:

— Vret hollë armiku, por po ia mbyllim mirë shtegun. Hm. Duan të sabotojnë kooperativën...

— Këtë mendim kishim dhe ne, — tha Blerta e lehtësuar.

— Bukur fort atëherë, — foli Gjoka. — Tani mirëupafshim. Më duhet të shkoj një copë herë deri në Manullë.

— Në Manullë? !..., — zgjata kokën unë, pa mundur të përmbaja shqetësimin që solli ky emër. Ky ishte fshati fqinj ku ishte mësues Genci. Përse po shkonte sekretari atje? Mos vallë përfjalët që ishin përhapur? Desha ta pyesja sekretarin, po e ndjeva në çast që s'mund ta bëja këtë. Kurse Blerta, edhe ajo e shqetësuar nga ai emër, kishte ngritur sytë dhe po e vështronte me hetim Gjokën.

— Kështu pra, — foli prapë Gjoka. — Ju mos u bëni hiç merak. Vazhdoni punën. Ah, përfpak harrova. A keni menduar gjë përf të dielën? Të dielën, pas një javë, formojmë kooperativën e parë të zonës dhe ju medoemos duhet të bëni diçka, ë?

Tani që kthyer në një njeri pothuaj krejt tjetër. Përsëri ai Gjoka i zakonshëm, i matur dhe babaxhan në fytyrë. Dukej sikur fjala kooperativë e përtërinte.

— Do të bëjmë patjetër, — foli Blerta. — Përkëtëbile do të na ndihmojë dhe Genci. Atij i vjen më shumë ndoresh.

— Genci?... — ky emër sikur e trubulloj pak, u vrenjt në fytyrë, po pas pak u çel sërisht. — Boll mirë. Edhe Genci...

U mat të shtonte dhe diçka tjetër, por hoqi dorë shpejt. Buzëqeshi, pastaj zgjati dorën e na përshëndeti. Kur po largohej, diç pëshpëriti nëpër buzë. Mua më ngjau sikur ai tha: «Hëm, i paburri...».

Në adresë të kujt e tha këtë? Në atë pëshpëritje, kishte një farë dhembje dhe revolte përzier bashkë. Blerta e shikonte e habitur, ndërsa ai po largohej gjithnjë e më shumë, duke tundur ato duart e tij të mëdha e të fuqishme.

Takimi me Gjokën ishte si një rreze e ngrohtë dielli në një ditë dimri. Buzëqeshja e tij hyri thellë në qenien tonë, si një ditë e kthjellët pas një stuhie. Dhe unë pyesja vreten: Vërtet zu të pastrohej aq shpejt «qielli» i ngjarjes, apo kjo ishte vetëm një hamendje, e cila ndillej nga ajo buzëqeshje e sekretarit? Jo. Duhej të ishte më tepër hamendje, sepse ngjarjen e mbulonin ende re të murme. Dhe sekretari i Partisë në atë takim nuk mund t'i shpërndante të gjitha ato, megjithëse kur u largua diç pëshpëriti në adresë të dikujt. «Hm, i paburri», ose diçka tjetër të ngjashme me këtë. Sidoqoftë, një gjë ishte e qartë: Kjo do të thoshte se Gjoka po i vendoste piketat mirë. Së shpejti çdo gjë mund të sqarohej.

Kështu mendoja unë, ndërsa Blerta, në kundërshtim me këtë, pas bisedës me sekretarin u bë papritur edhe më e zyrtë, edhe më e shqetësuar. I vinte jashtëzakonisht rëndë nga ai. Le të merrte dhenë e gjithë kjo punë, vetëm ai të mos e merrte vesh. Vetëm ai. Po kjo, afër mendsh, ishte e pamundur dhe atëherë; ajo zuri nga ato pyetjet torturuese që lindin zakonisht në të tilla raste. «Mos sekretari ka ndonjë fije dyshimi tek unë? Përse u turbullua kur përmenda emrin e Gencit? Çfarë dhe përse pëshpëriti kur u largua dhe, së fundi, përse po shkonte, vallë, në fshatin fqinj?».

Të gjitha këto pyetje hëpërhë mbetën pa një përgjigje të saktë, ndërsa ajo qëndronte gjithnjë e heshtur dhe e menduar.

Dhoma dukej si e zbrazët dhe e ftohtë. Ishte tretur ai gjësim i çiltër, ai gaz që shpërthente herë pas here mes nesh. Qe tretur papritur e pakujtar diku, mes grykave të ftoh-

ta, ku ererat rrihnin paprerë, si në një kazan të stërmadh. Prej atje duhej të kishte rrëshqitur ajo gjuhë e keqe si një kafshë e padukshme dhe e kishte prerë në mes gëzin min tonë. Kush ishte 'vallë? Mos ishte Shaba?... S'di sepse mendja më shkonte herë pas here tek ai. Vështrimi tij i vëngërt dhe nganjëherë me ligësi, më ngjethtë trupin. Mbase ai ishte «i paburri». Por jo. Shaba nuk mund të ishte në asnje mënyrë, sepse na ndihmonte, tregohej i afërt me ne, paçka se kishte ca gjëra të cilat s'ia pëlqej. Ç'i hynte në xhep atij nga kjo punë?... Po kush ishte atëherë? Prenga?... Istrefi?... Kush? Kush dhe përsë? Ç'i duhej gjithë ajo zvarisje nëpër natë, nëpër vatra, nëpër veshët e banorëve duke shfryrë ato bulçitë e tij të neveritur?... Të ishte vetëm kooperativa arsyaja e kësaj rendjeje? Po Blerta, ç'hynte në këtë mes?...

Disa nga malësorët zunë t'i mënjanoheshin veçanërisht asaj. Madje, atë pasdreke, kur shkuam në kullën e Prengë Shtjefnit, ai gati sa s'thirri nga inati. I kërleshur i gjithi iu drejtua asaj me zë të ashpër!

«Si ke ardhë këtu, oj mësuese?».

— Si mësuesja e vajzës sate, o Prengë! Për të dhe përvete kam ardhur.

— Unë të pyeta, si ke ardhë këtu, në kullën time?

— Ashtu siç është vajza yte e vogël, Prengë!

— Çfarë??

Zgjati kokën përpara i habitur, sikur atë çast ta kishin goditur befasisht që nga prapa.

— A nuk po na thua të ulemi njëherë? Kemi bërë një copë rrugë të gjatë pér të ardhur deri këtu.

Prenga u zu ngushtë dhe pas pak i bëri me kokë së shoqes. Sollën dy stola të drunjtë. Blerta u ul, pastaj foli:

— Më dëgjo, Prengë! Ti mund të na nxjerrësh edhe jashtë, por unë, si mësuesja e vajzës sate, kam ardhur të t'i them dy-tri fjalë. Ne nuk e njobhim kanunin dhe, të them

të drejtën, as na pëlqen ta njohim, sepse është i vjetër e i egër. Po megjithatë, kam dëgjuar se burrat nuk u bien në qafë vajzave e grave, sidomos kur ato nuk kanë asnjë faj. A nuk është kështu?

— Oj mësuese! Unë nuk i kam ra kujt në qafë.

— Po, Prengë! Më re mua. Neve.

— E pse?

— Erdhe e more pa të drejtë vajzën nga shkolla dhe veç kësaj, nuk po e dërgon më. Pse?

— Vajza ime e ka vendin këtu e jo atje.

— Jo, Prengë! Gabohesh. Mara yte e ka vendin në shkollë, po pse nuk e thua troç? Erdhi dikush e të pëshpëriti në vesh fjälë të paqena dhe ti u trubullove. I besove menjëherë asaj gjuhe të ligë dhe, veç kësaj, hoqe dorë edhe nga kooperativa. Mos, Prengë! Po gabon rëndë.

— Oj ti mësuese!, — ngriti kokën përnjëherë Prenga i inatosur.

— Unë kam ardhur në kullën tënde, Prengë! Veç kam ardhur e pastër, ashtu si Mara yte e vogël. Më beso.

Prenga turfulloi një copë herë, pastaj papritmas vari kokën e nuk foli. Blerta u ngrit dhe doli përjashta. Pas saj dhe unë...

...Ishte e qartë. Blerta dhe unë nuk kishim vend në vatrën e tij, s'kishim punë me «vajzën e tij të pastër».

Më vinte të pëlcisja nga inati, kurse Blerta tregohej e duruar. «Nuk ka fort rëndësi se ç'flasin. Rëndësi ka të mos pengojnë fëmijët të vijnë në shkollë».

Dhoma qe bërë e ftohtë akull. Kishim harruar të ndiznim zjarrin. Blerta hodhi dru në sobë pastaj më vështroi në sy, duke buzëqeshur lehtë.

— Ke ftohtë, Vera?, — tha.

— Kam, — i thashë.

— Ja tani do të ndizet zjarri dhe po gatuaj një supë të ngrohtë.

Buzëqeshi përsëri, pastaj shkoi pranë dollapit ku mbanim ushqimet. Pas asaj bisede të shkurtër me Prengë Shtjefnin, ajo ndihej më e lehtësuar dhe unë e shihja me kënaqësi një gjë të tillë. Nuk mund ta duroja heshtjen e saj. Isha mësuar ta shikoja gjithnjë të gëzuar.

Papandehur më shkrepri një mendim.

— Blerta, — fola e shqetësuar. — Po sikur ta marrin vesh ata të seksionit?

— Kush?, — pyeti dhe u vrenjt në fytyrë ajo.

— Ata të seksionit të arsimit.

— E çfarë pastaj?

— Mos i presin drutë shkurt, — thashë unë. — Për të mbyllur çdo fjalë, ata...

— Ata nuk mund ta bëjnë kurrsesi një gjë të tillë. Përse?

— Për punën, Blerta. Ti e di.

— Sidoqoftë, unë nuk lëviz në asnje mënyrë prej këtu. Kjo punë do të sqarohet shpejt.

Foli e shqetësuar dhe pas pak humbi në mendime. Më erdhi keq që e hapa atë bisedë krejtësisht të padëshiruar, po megjithatë unë e parandieja që ajo ngjarje nuk mund të lihej në heshtje nga seksioni i arsimit në rreth. Nxënësit po mungonin gjithnjë dhe ajo përshëndetje e ngrohtë «Mirëmëngjesi, zonjushë» që i jepte një kuptim të bukur ditës sonë, sikur qe ftohur. Të kishin marrë vesh gjë ata vocërrakë të urtë vallë? Oh, ç'gjë e tmerrshme!

Po sidoqoftë, Blerta e mbante veten para tyre dhe përpiquej të sillej ashtu si më parë...

Nisa të mërzitesha së tepërmë. Mendimi që një ditë mund të mbetesha pa Blertën më trubullonte keq. Për vete as që mendoja.

Në dhomë u dha papritmas sekretari i Partisë, Gjoka.

Trupi i tij i madh zuri një çast gjithë katorin e derës. Ishte mëngjes. Edhe pak e do të niseshim për në shkollë. Ardhja e sekretarit në atë kohë na habiti dhe për një minutë nuk folëm as njëra as tjetra. Domethënë se kishte diçka, për të cilën nuk priste koha.

Gjoka buzëqeshi lehtë dhe foli:

— A nuk po më ftoni të ulem, a?

Blerta e flaku në çast atë gjendje habie që na pushtoi porsa në derë u dha Gjoka.

— Urdhëroni, shoku Gjokë!, — tha ajo. — Nuk ju prisnim tani ç'është e vërteta, prandaj e humbëm paksa.

— Ani mirë, — buzëqeshi ai pasi u ul. — Ani mirë. Nuk besoj të kem ardhur pa kohë.

— Në asnje mënyrë. Mirë se erdhët!

Gjoka na vështroi një çast të dyja me radhë, pastaj kryqëzoi duart e mëdha në kraharorin e tij të gjerë.

— Pa hë, si janë mësueset tona të reja?

Në këtë pyetje të zakonshme, në dukje të largët dhe sikur s'na drejtohej neve po dikujt tjetër, por të cilën duhej të jepnim përgjigje, kishte në të vërtetë afrim, një afrim të ngrohtë e të çiltër.

Ktheva sytë nga Blerta. Ajo foli:

— Mirë, shoku Gjokë! Mirë, sidomos kur sekretari vjen në dhomën tonë për vizitë.

Gjoka qeshi. Pastaj i shëtitit sytë nëpër dhomë. Vështrimin e ndali në murin përballë, aty ku Blerta kishte vendosur dy-tri fotografi dhe ca pamje natyre që e tregonin dhomën gati-gati si një aneks ekspozite pa diçitura. Ndenji disa çaste duke vështruar fotografinë e babait të Blertës.

— Po ky oficeri?, — pyeti ai i menduar.

— Babai i Blertës, — thashë unë.

— Më duket sikur e njoh, — foli Gjoka. — A ka shërbyer ndonjëherë këtej nga ne?

— Po, — u përgjigj Blerta. — Para shtatë vjetësh. Ka qenë me forcat e ndjekjes.

— Ah, po, po. E njoh. Edhe më kanë folur për të.

— Si të kanë folur, shoku Gjokë?, — tha Blerta.

— Si për një burrë që s'i tutet syri para asgjëje, — tha e buzëqeshi ai. — Po nejse. A erdhi ndopak këtej Genci?

— Genci?!, — zgjata kokën e habitur. Sekretari ato tri ditë nuk kishte pyetur fare për Gencin dhe unë mendova se ai po hynte tani drejt e në temë.

— Po. A erdhi ndopak?

— Jo, — tha Blerta. — S'dimë se pse s'ka ardhur. Ndoshta nga dëbora.

— Nga bora?..., — foli në dialektin e tij Gjoka. — Ani mirë. Rruga do të hapet shpejt. Edhe korriera do të vijë.

Korriera ishte një autobus i vjetër Fiat që vinte një herë në dy ditë deri në fshatin tonë. Ardhja e tij na gjëzonte çdo herë, po kësaj radhe sepse më solli shqetësim. Për se e kishte fjalën sekretari? Për ardhjen e Gencit apo për ne? Në kundërshtim me natyrën e tij të hapur, ai po fliste tani paksa errët. Vërtet ato ditë kishte rënë dëborë e madhe, aq sa dhe korriera nuk kishte mundur të vinte, po Genci, megjithatë, mund të lëvizte nga fshati në fshat. Atëherë përsë foli për korrierën? Mos donte të na komunikonte mendimin që Blerta ose të dyja bashkë, në rastin më të parë duhej të shkonim në qytet? Me një fjalë, një transferim i imponuar nga rrethanat e krijuara?

Mendimi që u përf tua atë çast më bëri të hidhesha gati përpjetë dhe ta kundërshtoja sekretarin.

— Mos e keni fjalën për Blertën?, — thashë unë menjëherë.

— Për të dyja, — qeshi ai.

— Më falni, po kjo nuk është rrugëzgjidhje, — fola

me inat. — Kjo është njëlloj si ta pranosh atë që thuhet për ne, çuditem si keni arritur ju në këtë mendim!

Gjoka më shikoi një çast i habitur, po nuk foli.

— Sidoqoftë, — ndërhyri Blerta, — unë nuk lëviz prej këtu. Më kanë emëruar të punoj në këtë fshat dhe nuk shoh asnjë arsyё të largohem prej këtej.

— Aa, — qeshi sekretari me të madhe. — E keni gabim. Unë nuk fola ashtu si më kuptuat. E kisha tjetërkund. Thashë që do të vijë korriera. Bukur fort. Bashkë me të do të vijnë dhe disa shokë për kooperativën.

Qeshi përsëri, pastaj shtoi:

— Po nejse. Nuk erdha këtu për këtë punë. Hë, a erdhi sot këtej nga ju Shaba?

— Po, — thashë unë pa pikasur gjë në pyetjen e Gjokës.

— Besoj drutë kësaj radhe i solli të shkurtra, apo jo?

— Çfarë?

— A ju tha gjë?

— Jo.

Kujtova Shabën, që para disa çastesh solli ca dru në dhomën tonë, pastaj largimin e tij disi të hutuar e të shqetësuar.

— Po pse pyetët, shoku Gjokë?

— Jo, ashtu kot. Tashti ai s'do të ketë më mundësi t'ju afrohet.

— Përse?, — tha Blerta gati me një frymë.

— Ndoshta është pak herët të flasim për këtë, por sidqoftë unë do të vij pasdreke këtu. Mirë? Ndoshta vjen dhe Genci me kitarë. Vuri buzën në gaz, pastaj u ngrit të dilte. Te praku i derës u kthye dhe foli:

— Mos harroni veç shfaqjen. Të dielën. E dua prej jush!

— Patjetër, — buzëgashi dhe Blerta. — Të dielën.

— E po hajdeni pra. Shkojmë në shkollë, — tha ai duke qeshur.

Asnjëra nga ne s'bëri zë. Gjoka doli përjashta dhe ne vështruam njëra-tjetërën në sy. Përse do të vinte ai në shkollë?

Blera tha se sekretari me siguri vinte në shkollë për të parë klasat ku mendohej të bëhej mbledhja e së dielës për krijimin e kooperativës. Vuri buzën në gaz dhe veshi shpejt e shpejt pallton. Nga fytyra e saj rrumbullake dhe e lëmuar ishte zhdukur pothuaj çdo hije shqetësimi, ai muzg i huaj që i kishte bërë sytë e saj të bukur si të vrarë. Në vend të tij po ngjitej dalngadalë një ndjenjë tjetër e pastër dhe e fuqishme, që së shpejti do ta bënte atë po aq të gëzuar e të shkathët si më parë.

Ndihesha e qetë, megjithëse në një skutë të mendjes sime Shaba mbeti ende i pakuptueshëm dhe me atë vështrimin e tij tinzar.

Dolëm menjëherë përjashta. Gjoka po na priste disa hapa larg. Ai nuk erdhi atë pasdreke në dhomën tonë. Morëm vesh se papritur e kishin thirrur urgjent në Komitetin e Partisë së rrethit. Ndoi erdhi të na njoftonte se sekretari na kërkonte të falur që s'mund të vinte në kohën e duhur dhe se, porsa të mbaronte punë në qytet, do të dukej te ne.

Eh, ç'njeri që ishte Gjoka! Po përse ta kishin thirrur vallë kaq urgjent? Ndoi nuk tha asgjë më shumë. Ai ndejni një copë herë në dhomë, pastaj porsa zu të errej u largua. Ne mbetëm disa çaste të heshtura. Shqetësimi që na kishte pushtuar nga vonesa e sekretarit tashmë qe tretur dhe vendin e zunë dhjetëra pyetje, dhjetëra hamendje që lindnin njëra pas tjetrës nga ato dy fjalë që ai tha për Shabën atë mëngjes. Të ishte vërtet Shaba njeriu që kishte pëshpëritur andej-këtej?

Solla nëpër mend tiparet dhelparake të fytyrës së imtë

të Shabës, atë vështrimin e tij të vëngërt, që nganjëherë nglulitej me ligësi, pastaj papritmas ditën kur ai më kërroi vërtetimin për drutë që kishte sjellë në shkollë. «Përse e do, o Shabë?... «Kot, oj zonjushë! Kot. Veç ta kem në xhep». Po. Patjetër Shaba duhej të ishte njeriu që kishte shpifur. Ai... Po një dreq e merr vesh këtë punë. Përse i duhej gjithë kjo atij? Nëse fjala ishte për kooperativën, ç'hynim në këtë mes ne dhe në mënyrë të veçantë, Blerta?

Cështë e vërteta, atëherë nuk isha dhe aq në gjendje t'u jepja përgjigjen e duhur këtyre pyetjeve, ndërsa Blertë, dukej sikur kjo nuk e shqetëson dhe aq. Asaj, me sa shihej, i mjaftonte vetëm korrektesa e Gjokës, si dhe fjalët që tha për Shabën. Kaq. Dhe e ndiente veten të qetë. Vështrimin ia kishte mbërthyer kullës së Istrefit. Atje e kishte mendjen.

— Vera!, — foli papritur ajo. — Shkojmë te Sanija?

— Te Sanija?!

— Po. Më ka marrë aq shumë malli për të, sa nuk ta merr mendja. Edhe ajo besoj na pret.

— Jo, jo, — thashë unë. — Nuk lëviz prej këtej pa ardhur Gjoka. Pastaj, të them të drejtën, kam frikë nga ai Istrefi. Se si më duket qysh nga dita kur erdhi te ne.

— Dëgjo këtu, o kulmi i seriozitetit!, — qeshi Blerta.

— Më vjen keq që gjatë kësaj kohe nuk jam marrë fare me ty, more vesh? Po megjithatë, ja ku po të them se do të të gdhend mirë e mirë. Hajde pra të shkojmë.

— Të thashë një herë që s'vij dhe pikë, — kundërshtova unë. — Dhe sa për atë gdhendjen, të cilën paskérke ndër mend të më bësh, nuk është aspak nevoja, sepse kam marrë një mësim aq të mirë këto ditët e fundit, sa është krejtësisht e kotë të lodhesh.

Blerta qeshi, pastaj shtoi:

— Do të vish, apo të shkoj vetëm?

— Këtë nuk do ta bësh, — u ankova unë. — Ti e di që mua s'para më pëlqen të rri vetëm.

Blera ndenji disa sekonda në këmbë, si në mëdyshje, pastaj u ul pranë tavolinës. Hapi një libër dhe nisi të lexonte.

Përjashta kishte rënë napa e zezë e natës. Rrokullima e erës luante sërisht me teneqenë në strehën e shkollës dhe që atje vinte nganjëherë gërvima rrëqethëse e saj. «Si nuk u kujtova ta rregulloja, — murmurita dhe pashe Bler-tën. Ajo lexonte e qetë. Atë çast nga jashtë erdhi papan-dehur një zë, më tepër një britmë e mbytur që u trazua në çast me ca zëra të tjerë. Ata u afroan në fillim, pastaj humbën diku thellë, si t'i kishte përpirë nata.

Blera u ngrit menjëherë dhe doli përjashta. Pas saj, dola dhe unë. Dëbora kishte pushuar, po era vazhdonte të frynte e ftohtë brisk. Shtroja e ngrirë e dëborës i jep-te natës një ndriçim të zbetë dhe nga kjo arsyе sendet shquheshin pak a shumë qartë. Tutje, aq sa hante syri, dukeshin tre njerëz të cilët ecnin ngadalë duke shkëmbyer lëvizje të shpeshta mes njëri-tjetrit. Dy prej tyre ishin shtatëlartë, ndërsa në mes, sikur ta tërhoqin zvarë, mezi çapiste një njeri trupshkurtër. U drodha. Ai njeri më ngjau krejt si Shaba. Trupi i tij i shkurtër, ndoshta nga nata ose nagaqë lëvizjet e dy burrave të tjerë i drejtoheshin vetëm atij, që mpakur edhe më shumë, sikur po zhytej gjithnjë e më thellë në tokë.

Ç'kishte ngjarë vallë? Ajo britmë që u dëgjuva papritisë, nuk ishte e zakonshme. Ajo i ngjante më shumë zërit të inatosur, të revoltuar.

Blera tha se kjo me siguri do të qe ndonjë zënie e rastit, pastaj hyri në dhomë dhe u shtri në shtrat, pa u dhënë më rëndësi zërave.

— Blera!, — thashë unë. — I njohe ata dy që ishin anash?

— Jo.

— Ai i mesit më ngjau krejt si Shaba.

— I ziu Shabë, të është shpifur keq në tru. Jo, Vera! Nuk ishte ai.

Nuk ngula këmbë. Shova dritën dhe rashë të flija. Nëpër kokë u vërtit për një kohë të gjatë sekretari i Partisë, britma dhe më pastaj njeriu trupshkurtër që zvarisej nëpër natë mes dy burrave të tjerë. Trupshkurtri që patjetër Shaba, paçka se Blerta... Nuk po u rezistoja më lodhjes dhe mendimeve që vinin e iknin tamam si në një garë vrapiçimesh të shpejta. Më zuri gjumi.

Ditën tjetër, aty afér drekës, në derë u dha Gjoka me Ndoin. Sekretari ishte i gjëzuar. Ngjante sikur nga komiteti i Partisë kishte sjellë me vete lajme mjaft të rëndësishme dhe për këtë, si në çdo rast të tillë të shënuar, qe veshur me rroba të reja dhe flokët i kishte shtruar me një kujdes të veçantë. E gjithë pamja e tij dukej sikur thoshte: «Bukur fort. Punët tashti shkojnë fare mirë».

— Hë, — tha Gjoka, porsa u duk në derë. — A u mërzitët ndopak?

— Jo dhe aq, — buzëqeshi Blerta. — Po ju prisnim.

— E po të më falni. Më thirrën urgjent në komitet dhe s'kisha si t'ia bëja.

Mbetëm disa çaste në këmbë. Ndoi foli duke qeshur:

— A s'po na thoni të ulemi njëherë, a?

— Urdhëroni!, — u kujtua Blerta. — Mirë se erdhët!

Ata u ulën. Gjoka rrotulloi një çast vështrimin nëpër dhomë, pastaj pyeti:

— Po Genci, nuk paska ardhur ende?

— Jo, — u përgjigja unë pak e habitur nga kjo pyetje e papritur. — Pse?

— I kam çuar fjalë të vijë. Po vjen e diela. Ka bërë gjë për atë shfaqjen?

Buzëqesha e lehtësuar. Gjoka fërkoi duart dhe i zgjati

përpara, drejt sobës së ndezur flakë. Atë çast Blerta i foli Ndoit për Dilën:

— Ndoi!, — tha ajo, — të ka shkruar letër Dila?

— Mos, oj mësuese! Ç'asht ajo fjalë. Dila asht tretë mbas librave e qytetit dhe më ka harrue krejt, — qeshi ai.

— Po ti, nuk i ke shkruar?, — pyeti sërisht Blerta.

— Bah. Pa më shkrue njëherë ajo, si kam me i shkrue unë? Burrë hesapi!

Qeshëm një minutë me shakanë e Ndoit. Pastaj trokiti dera. Në dhomë hyri Genci. I qeshur si gjithnjë, por me një ndryshim. Kësaj radhe ai nuk e kishte marrë kitaren me vete dhe, sikur ta dinte që Gjoka ishte aty dhe e priste, nuk plotësoi atë formulën e tij të zakonshme. «A janë të lira zonjushet tona mësuese?».

— Mirëdita!, — përhëndeti Genci.

— Mirëdita!, — vuri buzën në gaz Gjoka. — A nuk e paske marrë kitaren me vete, a?

— Po pse, duhej patjetër?, — tha Genci disi i hutuar.

— Duhej që ç'ke me të, po nejse. Ulu njëherë e merr një dorë zjarr. Gjoka heshti një copë herë, ndërsa fytyra e tij e gjerë babaxhane, u bë papritur e menduar. Ishte e qartë, ai po bëhej gati të fliste, të hidhte dritë mbi atë kapitull, i cili një ditë më parë kishte mbetur i pambaruar. Sytë e tij u bënë të gjallë e të lëvizshëm.

— Kështu pra, — tundi kokën ai i menduar. — Mbrëmë deshën t'i vinin zjarrin shkollës sonë.

— Shkollës?! — zgjata kokën e habitur.

— Po, oj mësuese, po, — foli Ndoi, kësaj radhe i menduar.

— E kush?

— Ai i paburri, Shaba, — turfulloj Ndoi, — Po nuk arriti. E kapëm.

Për disa sekonda dhomën e pushtoi heshtja. Unë kuj-

tova zérat e natës së shkuar, britmën, pastaj dy burrat, të cilët têrhiqnin zvarë një të tretë, trupshkurtër dhe përsëri ndjeva të rrëqethesha. Nuk isha gabuar. Ai njeri kishte qenë Shaba.

— Po ç'kishte me shkollën?, — pyeti Blerta e hutuar.

— Dhelpra e ligë, oj mësuese!, — tha Ndoi. — Ai e pa se ato fjalë që hapi për ju andej-këtej nuk po bajshin dobi për shkatërrimin e kooperativës, se aty e kishte hällin, atëherë mendja e zezë i tha të digjte shkollën. Bisha e plagosun e ban gjamën ma të madhe.

— Kjo éshtë e çuditshme, — pëshpëriti Blerta. — Nuk ma priste kurrë mendja që Shaba... Ai na ndihmonte.

— Mos, oj mësuese!, — foli sérish Ndoi. — Sermi i Shabës ishte helm i zi.

— Çdo gjë që shndrit, nuk éshtë ar, moj Blertë!, — tha Gjoka ngadalë duke u mëshuar mirë fjalëve. — Shaba qe me shpirt armik. Ai e mori vesh prej teje që Prenga me Mal Kirin e dhanë më në fund fjalën për kooperativën, atëherë vrapi e shpifi për ty, sepse ti u kishe shkelur në vatër për këtë punë dhe, veç kësaj, fëmijët e tyre ishin nxënësit e tu. Kështu, ata humbën besimin te ti dhe u lë-kundën për kooperativën... Punë e hollë.

— Punë tamam armiqësore, — shtova unë.

— S'e luen as topi, — u hodh e tha Ndoi. — Shaba nuk donte asgja tjetër, veç vetes e mallit të tij dhe për këtë ishte gati të bante çdo gja, mjافت që ajo të mos i ikte nga duert. Njeriu që do vetëm veten, si kërmilli samarin ë tij, bahet ma i rrezikshëm se gjarpni. Edhe Shaba ashtu ishte, por nuk i eci. Vetëm sa pickoi.

Ishte e qartë. Tashmë gjuha e neveritur e Shabës qe prerë. Filli i errët, të cilin Shaba, si një merimangë e hel-mët, kishte endur në dëm të kooperativës, qe grisur një-herë e përgjithmonë. Po megjithatë, mbetej ende diçka pa sqaruar. Unë mendoja për Blertën dhe për nxënësit të ci-

lët vazhdonin të mos vinin në shkollë. Për këtë arsyefola:

— Besoj këtë e morën vesh të gjithë, shoku Gjokë!

— Po. Patjetër. Pse? Ah, — shtoi pastaj ai, duke kujtuar shkakun e asaj pyetjeje. — Mos u bëni merak. Nesër, në mëngjes, Prenga e bie vajzën në shkollë. Edhe Mal Kiri. Ishin trubulluar keq nga gjuha e Shabës.

Më besoni. Unë, vajza e zymtë ose, siç më quante shpesh Blerta, «Kulmi i seriozitetit», atë çast isha gati t'i hidhesha në qafë sekretarit dhe ta përaqofoja. Sa kisha ndryshuar ato ditë. Po sidoqoftë, këtë nuk mund ta bëja. U përbajta. Gjoka ktheu sytë nga Genci dhe tha:

— Megjithatë, ti ke gabuar, o Genc! Kitaren duhej ta kishe marrë me vete, apo jo?

— Shkoj e marr tani, për besë, — u ngrit dhe qeshi Genci. — Me vrap.

— Jo, jo. Ulu. S'kemi ndër mend të presim gjithë natën këtu. Ditët tonat janë.

Ndezi cigaren që porsa mbaroi së dredhuri, pastaj u ngrit dhe iu drejtua Blertës:

— Dëgjo këtu, oj mësuese! Do të ta heq pak veshin. Nuk po bën hiç mirë që ke harruar Sanjen. Istrefi është burrë i mirë, po helbete, njeri është edhe ai.

Qeshi dhe pas pak doli. Pas tij dhe Ndoi. Blerta e skurur në fytyrë i përcollti deri matanë derës, pastaj u kthyte e gëzuar. Iu shkreh papritur Gencit: «Lëviz ti, Pushkin! Medet që s'e more sot kitaren me vete».

Genci lëshoi një «Bah» të përsëritur, pastaj u përkul paksa para meje. «Zonjusha Kulm!, — qeshi ai, — para se të largohem dëshiroj të më dhurosh një buzëqeshje. Vetëm një dhe unë do të ta kthej atë në çast në një tingull të këndshëm kitare. Hajde pra, po pres!».

Buzëqesha e kënaqur. Genci ia krisi gazit. Dhoma ishte bërë e ngrohtë, shumë e ngrohtë.

## VII

— Mirëmëngjesi zonjushë! Mirëmëngjesi, zonjushë!

Kjo përshëndetje aq e njojur e nxënësve të vegjël gjatë rrugës dhe atje, në oborrin e vogël të shkollës, fshiu përfundimisht, si me një pëllëmbë të madhe e të butë gjithë zyminë e ditëve që ikën. Mëngjesi qe i bardhë e i qetë.

Nxënësit po vinin pothuaj të gjithë, njëri pas tjetrit. Nuk dukej ende vetëm vajza e Prengë Shtjefnit. Dy fëmijët e Mal Kirit, që të dy nxënës të Blerta kishin ardhur me kohë dhe tani qëndronin të druajtur, paksa mënjanë të tjerëve. Blerta, porsa i pa, iu afrua, u foli diçka duke qeshur, ndërsa ata e shikonin në sy, si fajtorë që nuk e kuptonin ende mirë fajin e tyre. Çdo gjë po rikthehej në vendin e vet. Vetëm vajza e Prengës dhe Sanija... Tutje, nga oborri i kullës së Istrefit erdhi zëri i ngjirur i një këndesi, pastaj pëllitja e një lope. Ndanë lesës u dha Istrefi me një vandak bari në duar. Sanija nuk dukej.

Blerta thirri e gjëzuar:

— Vera! shiko! Po vjen Prenga!

Nëpër rrugën ku njerëzit, qerret dhe kafshët kishin sajuar një baltë të bardhë trazuar me njolla të kuqërrreme, po ekte ngadalë Prengë Shtjefni me vajzën e tij për dore. Nxënësit ishin futur të gjithë në klasa. Dukej sikur maliësori i gjatë e i vrenjtur kishte pritur pikërisht këtë çast të vinte në shkollë. Nuk donte ta shihte njeri, goftë dhe ne.

Ai qëndroi papritur disa dhjetëra metra larg shkollës dhe diç i tha vajzës. Po ajo siç dukej e kundërshtoi mendimin e të atit, sepse e kapi nga dora dhe kërkoi që ai ta shoqëronte deri brenda, në shkollë. Prenga, i detyruar lëvizti dhe pas pak hyri në oborr.

— Mirë se erdhe, Prengë!, — i doli përpara Blerta e kënaqur.

— Mirëmjesi! — foli me gjysmë zëri ai. Dukej që kish-

te hequr shumë për të ardhut deri aty. Blerta i foli pastaj Marës dhe ajo u shkëput në çast nga i ati. Iu afrua ngadalë mësueses si e turpëruar.

— Si je, Marë?, — përkëdheli Blerta vajzën e vogël.

— Mirë, zonjushë!, — mezi shqiptoi ajo.

Prenga pëshpëriti diçka nëpër buzë, pastaj buzëqeshi lehtë. Sikur tha: «Na i fal kusuret, oj mësuese. Kokë e pagdhendur mirë kjo jona». Tundi kokën dhe u largua. Blerta foli:

— Mirupafshim, Prengë! Dil ndonjëherë këtej nga shkolla. Malësori i gjatë e i vrenjtur nuk u përgjigj. Vazhdoi të ecet me hapa të mëdhenj nëpër rrugën që ngjitej kodrës së zbardhur nga dëbora.

Kishin ardhur përsëri ditët e qeta. Blerta merrej me preqatitjen e shfaqjes për ditën e diel dhe në dhomë vinte vetëm me të rënë muzgu i mbrëmjes. E qeshur dhe e shkathët si gjithnjë, vetëm se nganjëherë, papritur e pakujtuar binte në mendime. Kishte mbetur dhe diçka tjetër e rëndësishme pa shkuar në vendin e vet: Sanija, Istrefi... Ajo e ndiente mungesën e Sanijes dhe të nesërmen e asaj dite kur Prenga solli vajzën, shkoi në kullën e Istrefit. Pas dy orësh u kthye e mërzitur. Me sa shihej, Istrefi nuk donte të merrte vesh. Ajo natyra e tij e veçuar kishtë bërë që ai ta kyqtë përbrenda të keqen dhe, kësisoj, që e vështirë të hapje dritare nga të hynte drita e pastër dhe në shpirtin e tij. Kjo mbetej plagë për Blertën dhe përmua.

— E di, Vera!, — tha Blerta, — sot punët e shtëpisë i rregulluam së bashku me Sanijen. Gati sa s'fluturonët nga gëzimi e shkretë.

— Po Istrefi?

— Si gjithnjë, i heshtur. Kërcu i bardhë.

— Mbase është zbutur ca, — thashë unë. — Dje pas hë Gjokën të shkonte në kullën e tij.

— Sidoqoftë, ai vazhdon të më shikojë si me dyshim. Kushedi ç'mendon.

— Mos u bëj merak, Blerta, — buzëqesha. — Edhe këtu, rruga do të hapet së shpejti. Jam e bindur.

Blerta ngriti kokën dhe vuri buzën në gaz.

— Ke filluar të flasësh me gjuhën e sekretarit të Partisë?

— Do të kisha dëshirë gjithë jetën të flisja me atë gjuhë.

— Oi, kulmi i seriozitetit!

— Mos u tall, Blerta! Nuk dua të më thérresësh më ashtu.

Nuk munda ta përbaja veten. Qesha. Dhe Blerta qeshi.

— E di, Vera!, — foli ajo pas pak e menduar. — Në një farë mase nuk më vjen dhe aq mirë që Gjoka shkon atje, te Istrefi. Si të thuash, unë kam dëshirë që lopatën më të madhe të dheut ta heq vetë.

— Do ta heqësh, jam e bindur për këtë por, nuk është dhe aq kollaj.

Solla në mend Gjokën, atë shprehjen e tij «S'ka hall e gëzim që të mos e dijë Partia», — dhe buzëqesha.

— Ndoshta nuk është vërtet e lehtë, por mua kështu më pëlqen, — tha Blerta e vendosur. — Nuk kam qejf që dikush tjetër të shkojë përpëra dhe të më hapë rrugën.

— Edhe në qoftë se ky njeri është Gjoka?, — pyeta unë jo pa qëllim.

Blerta heshti një çast. Sikur u zu ngushtë. Në fytyrën e saj të ëmbël u dha një notë qortimi trazuar me gëzim. «Nuk duhej të ma bëje këtë pyetje, Vera!, — thoshin sytë e saj. — Nuk e kam fjalën për Gjokën».

Të nesërmen, pas provës përfundimtare me nxënësit «artistë», shkuam bashkë në kullën e Istrefit. Sanijen kisha

kohë pa e parë. Që nga ajo ditë kur ajo erdhi në dhomën tonë e i tha Blertës: «Pse, je vajzë e keqe ti, zonjushë»? Po bëhej gati një muaj. Istrefi nuk e linte të dilte as te dera. Ta kishte marrë vesh vallë Sanija që mësuesja e saj e mirë, shoqja saj e madhe, nuk kishte të bënte fare me ato fjalë që u pëshpëritën në fshat? Me siguri që po. Unë e përfytyroja të gjëzuar Sanijen dhe nuk u gabova aspak. Porsa na pa, ajo e shprehu hapur kënaqësinë e saj, kurse Istrefi nuk luajti fare nga vëndi. Ai ishte ulur ndanë vatrës, si gjithnjë i heshtur dhe po thithte duhan nga llulla e tij e vjetër. Atë ditë, më ngjau mua, heshtja dhe vrazhdësia e tij e kalonin cakun e këtyre fjalëve dhe unë ndjeva të ftohtë. Dhe, përsë ta fsheh, nuk kisha dëshirë të mërresha me të.

U ulëm ndanë vatrës, mbi një lëkurë të butë me lesh të kuqërrëmtë. Në vatër qe ndezur një zjarr i madh, me gjithse përjashta nuk bënte dhe aq ftohtë. Heshtëm për disa çaste. Në fytyrën e hequr të Istrefit gjuhët e flakës sajonin një mishmash refleksesh dritë-hije. Ndërsa Sanija na vërshtonte me bisht të syrit, e heshtur po e kënaqur.

Në një çast Blerta ngriti kokën dhe vështroi lahitë, të cilën Sanija e kishte varur në të majtë të oxhakut. I zoti saj nuk kishte ndër mend të fliste. Shikova profilin e ash-për të tij dhe papritmas më shkrepri një mendim në kokë. Ç'gjë e bukur do të ishte sikur Istrefi të dielën, ditën e krijimit të kooperativës, t'i binte asaj lahute...

Po kjo qe vetëm një hamendje, dhe unë buzëqesha me veten. Atë çast Blerta foli:

— I qenkan ndryshkur telat lahitës, xha Istref!

— Si?

Ai ngriti menjëherë kokën e zbardhur para kohe dhe e shikoi gjatë në sy Blertën. Ashtu u duk sikur po bëhej gati të thoshte: «Oj mësuese! A nuk më le rehat në kullën time. E di që jeni vajza të mira, po buka që thyhet nji

herë, nuk ngjitet ma. Mbajeni vath-në vesh këtë prej meje». Po nuk foli. Ç'mendonte vallë ky njeri, të cilit i qeshte buza rrallëherë, por që çuditërish u pajtua me praninë tonë në vatrën e tij? Përgjigjen ndoshta duhej ta kërkonim në sytë e Sanijes. Ata ishin të gëzuar, kur ne zinim e flisnim dhe të drujtura, kur odën e pushtonte heshtja. Ishte pra ende herët të mësonim nga vështrimi i Sanijes shpirtin e Istrefit.

— Xha Istref!, — theu heshtjen Blerta, pasi shëtitit njëherë vështrimin nëpër odën e madhe të zjarrit. — Kulla duhet lyer me gëlgere. Është nxirë shumë.

Istrefi uli kokën.

— Në këtë votër s'ka për të lindë ma njeri dhe kulla mirë asht kështu si asht, — ia preu shkurt ai.

— Po Sanija?, — vazhdoi Blerta.

— Sanija!... .

Balli iu rrudh, vetullat e trasha si strehë iu kërleshën dhe ashtu u duk se do të shpërthente: — E çfarë, Sanija?

— Sanija është e re, xha Istref! E zgjuar dhe duhet të mësojë.

— Boll ka mësue, — ngriti zërin e ngjirur ai. — Shkolla e shumtë ia prish mendjen vajzës.

— Xha Istref!

Në zërin e Blertës u ndie një notë revolte. Ajo e vështroi Istrefin një çast me hetim, pastaj shtoi:

— Si mua?

Istrefi nuk foli. Shtyu një copë dru në zjarr, ndërsa në fytyrën e tij të rreshkur u pasqyrua flaka. Dhoma qe bërë e errët.

— Fol, xha Istref! Ti kujton se shkolla do t'ia prishë mendjen Sanijes, ashtu siç ma ka prishur dhe mua, apo jo?

— Mos e përmend ma atë fjalë, oj mësuese!

— Atëherë pse nuk e lejon të mësojë, të shkojë në shkollë?

— Hm...

Istrefi heshti dhe tundi kokën. Nuk u mor vesh nëse ajo tundje koke shprehte mohim apo pohim, veçse në vështrimin e tij të thellë u pasqyrua atë çast dhembja tra-zuar me një farë mëdyshjeje, të cilën ai nuk po e largonte dot. Blerta shkoi më tej:

— Ti duhet të kesh besim te ne, xha Istref! Unë jam vajza jote, e dua Sanijen, të mirën e saj dhe tënden, ash-tu si e do bash ti, prandaj ma jep dorën, si burrat.

«Si burrat... Pasha besën, kjo vajzë asht burrë e shkue burrit. Hej, ç'vajzë e fortë që asht. Por...».

Koka e zbardhur e Istrefit ishte lëshuar mbi gjoksin e tij të lënë gati përgjysmë përjashta dhe tek e vështroje ash-tu, të krijohej përshtypja se ai qe dorëzuar. I qe dorëzuar asaj vajze, e cila po i fliste aty afër, ndanë vatrës së tij të lashtë.

— Babë!, — tha për herë të parë Sanija, e cila, me sa dukej, mori zemër nga fjalët e Blertës. — Më len të shkoj në shkollë. Edhe Dika e Zanit shkon. Edhe...

— Pusho ti aty, — foli me inat Istrefi, duke kthyer fytyrën nga Sanija.

— Lokaliteti nuk asht larg, o babë! Dy orë...

— Mjaft! Boll ke mësue. Shkolla e shumtë...

E la fjalën përgjysmë dhe vështroi për një copë herë në heshtje flakët e zjarrit. Ato ishin mekur dhe tani ngjanin si ca gjuhë të kuqe, të cilat endeshin andej-këtej me re-gëtima.

— Xha Istref! Njeriu i pamësuar i ngjan kullës së nxirë nga bloza. Prej teje e kam mësuar këtë.

— Çfarë?

— Më dëgjo, xha Istref! Sanija duhet të mësojë për të mirën e saj, për të mirën e të gjithëve dhe kulla duhet të lyhet sa më parë me gëlqere.

Istrefi murmuriti ca fjalë që s'u morën vesh ç'kuptim kishin. Pastaj hungroi sérish.

— Vijnë ne e lyejmë, xha Istref! Bashkë me Sanijen.

Ai çoi ngadalë kokën, si tē mos u besonte atyre fjalëve që dëgjoi. Pas një minute e uli përsëri dhe nuk foli më. Ishte hera e parë që ai burrë i ashpër la kokën t'i varej ashtu, sikur iu këput në çast e i ra mbi gjoksin eshtak. Dhe në atë rënie kishte diçka nga bindja, nënshtimi, ose ku ta dish, ndoshta qëndroi ashtu se nuk donte më t'i frynte zjarrit tē asaj bisede. Sidoqoftë, unë mendoja se ai ishte pikë pér pikë dakord me mendimin e Blertës, po këtë e kishte tē vështirë ta thoshte aty pér aty. Dhe doemos, nuk duhej tē pritej kaq shpejt kjo gjë.

Në odën e madhe, ku erërat grindeshin paprerë me muret e nxira, ra një heshtje e thellë. Blerta u ngrit, përshëndeti Istrefin, pastaj Sanijen dhe u nis tē dilte.

— Tē dielën pasdreke do tē vijnë, xha Istref! Mirë?

Istrefi i thinjur e i mbledhur gati kutullaç atje, ndanë vatrës, nuk foli. Vetëm seç pëshpëriti ca fjalë, tē cilat sërisht nuk u morën vesh ç'kuptim kishin. Pas kësaj, ne dolëm pérjashta, duke lënë prapa sytë e qeshur tē Sanijes.

## VIII

Në oborrin e shkollës, tē cilin Ndoi me dy fshatarë tē tjerë e kishin rrrethuar me listela tē reja prej dru ahu, ishin grumbulluar shumë burra, gra e fëmijë. Asnjëherë nuk ishte parë tē mblidheshin aq shumë njerëz brenda atyre pak metrave tokë; që tani kishin marrë emrin oborri

i shkollës, por që malësorët vazhdonin ta quanin «Sheshi i kuvendit».

Sheshi pra do të hynte së shpejti në historinë e këtij fshati. Kuvendi i ri ende nuk kishte filluar dhe ndërkohe burrat bisedonin mes njëri-tjetrit dy nga dy e tre nga tre, ndërsa vështronin herë pas here nga dera e shkollës, prej ku pritej të dilnin Gjoka dhe Ndoi me dy shokë të tjera të ardhur nga qyteti.

Ata tymosnin pareshtur llullat, kurse gratë, të veshura me kostumet e tyre të qëndisura dhe me pështjellakët tërë ngjyra të ndezura mbi kokë, qëndronin paksa mënjanë duke vështruar herë nga burrat dhe herë nga fëmijët, të cilët, kundër natyrës së tyre, atë mëngjes ishin bërë seriozë dhe nuk luanin. Kjo ndodhje mbasë ngaqë ata për herë të parë i shihnin baballarët e tyre të mbledhur tok, tek bisedonin ciltër me njëri-tjetrin.

Të gjithë ishin aty. Vetëm Shaba mungonte. Kishte ardhur mëngjesi i së dielës. Po krijohej kooperativa e parë e zonës. Dëbora pat pushuar dhe shtroja saj e bardhë ndrishte nga një sy i vakët dielli, që ishte ngjitur mbi kreshtën e malit, tutje nga lindja. Frynte pak erë. Duhma e saj tra-zonte nganjëherë sipërfaqen e ndritshme të dëborës, duke ngritur lart qindra e mijëra grimca kristalike, si saçmatë ftohta. Në divizën e bardhë të fshatit, këto re saçmash dukeshin gati si gjuhë të hallakatura, të cilat po shuheshin njëra pas tjetrës.

Vështrova Blertën. Ishte e gjëzuar. Kishte qëndruar në cepin e majtë të shkollës, mes katër nxënësve të saj dhe diçka u fliste. Qe përfshirë e tëra nga ajo që po thoshte, ndërsa nxënësit ndiqnin me vëmendje lëvizjet energjike të duarve të saj. Të vinte për të qeshur tek e shikoje ashtu Blertën mes atyre katër fëmijëve, që ishin artistët e saj të vegjël. Dy recitues, një këngëtarë e cila këndonte për herë të parë faqe fshatit dhe, natyrisht, dridhej nga emocionet,

dhe së fundi një djalë rrëth dhjetëvjeç me çifteli, për të cilin Blerta thoshte se ishte virtuozi. Aty pranë saj jepte e merrte dhe Genci me kitarë. Ai kishte ardhur para një ore më pesë fëmijë, djem e vajza, veshur bukur si për ditë festë. Në duar mbanin kush çifteli, kush lahitë, ndërsa fytyrat e njoma u ndrisnin nga gjëzimi.

Ky ishte karvani artistik i Gencit, që së bashku me atë të Blertës, sajonin një ansambël të vogël e të këndshëm. Veçse këtu mungonte diçka: lahuta e Istrefit. Eh, ç'gjë e bukur do të ishte sikur dhe ai të ishte aty, mes atyre fëmijëve artistë. Por jo. Ai kishte ardhur pa lahitë. Bisidentë mënjanë me Prengë Shtjefnин dhe nganjëherë i hidhte sytë nga Blerta. Në një çast madje u vrenjt dhe fytyra e tije hequr me dy sy të thellë, të përhimët, u rruadh edhe më shumë. «Ç'pat Istrefi?», — mendova e habitur dhe i ktheva sytë anash. Sanija! Drejt nesh po vinte Sanija. Ajo ecte ngadalë dhe si me pendim, duke shikuar herë nga ne herë nga i ati.

Ndjeva të rrëqethura. Mos do t'i fliste tani ai Sanijes? Jo. Ky ishte një shqetësim i kotë. Sanija u afrua e druar dhe tamam atëherë fytyra e Istrefit u çel dhe pas kësaj, në të u dha një buzëqeshje që mezi u vu re.

Më shkrua gjaku. Blerta nuk u përbajt dhe e përqafoi Sanjen faqe të gjithëve. Në sytë e njomë të Sanijes u ngjit menjëherë një botë e tërë ndjenjash të pastra, që ia bënë ninëzat të papërshkrueshme. Qe një rikthim i plotë te vetja. Blertës iu lidh papritur gjuha dhe nuk foli asnjë fjalë. Kur deshi të fliste, në derën e hapur të shkollës u duk trupi i madh i sekretarit të Partisë. Ai u foli malësorëve.

— A hyjmë, burra?

Disa çaste u bë zhurmë. U dëgjuan zëra, thirrje fëmijësh, pastaj të gjithë, në heshtje, hynë njëri pas tjeterit në klasën e Blertës. Ajo ishte e madhe dhe i zinte pothuaj

të gjithë, ca ulur, ca në këmbë. Ne e kishim zbukuruar atë me parulla, në krye flamurin dhe mbi tavolinë Blerta kiste vendosur vazon tonë me lule të kaltra.

Oborri i shkollës sakaq mbeti i zbruzur. Qëndruam përjashta vetëm ne dhe nxënësit që, pas asaj mbledhjeje të parë të fshatit për krijimin e kooperativës, do të jepnin shfaqje. Blerta me Gencin dhanë me një herë porositë e rastit, pastaj, kur u bindën se çdo gjë shkonte në rregull, u afroan tek unë dhe Sanija.

— S'kemi ç'bëjmë, — tha Genci, serioz në fytyrë. — Ti, zonjusha Kulm do të bësh prezantimin e shfaqjes. Mirë? Njeri më të përshtatshëm se ti s'ka.

— U lodhe shumë ta mendosh, — qesha unë me shakanë e tij. — Gjete kë të caktosh.

— E pse?, — tha përsëri Genci. — Prezantuesi duhet të jetë gjithnjë serioz, apo jo, Blerta?

— Ashtu mendoj dhe unë, — foli Blerta. — Bëhu gati, Vera!

— Do të më lini rehat tanë, apo doni të iki prej këtu?

Blerta me Gencin ia dhanë të qeshurit. Qeshi dhe Sanija. Atë çast që nga brenda klasës ku po zhvillohej mbledhja, erdhën disa zëra të lartë. Atje biseda kishte marrë zjarr shpejt. U dëgjua së pari zëri i Prengë Shtjefnit, pastaj ai i Mal Kirit që fliste ngadalë, duke i shqiptuar fjalët me kujdes. Të dy ata thanë se mendjen e Partisë e kishin parë me kohë në zemrat e tyre, por u qenë ngatërruar nëpër këmbë ca ferra që nuk i kishin lënë të ngrinin krye për disa javë rresht dhe për këtë i kërkonin fshatit të falur. Sa për kooperativën, ata ishin gati të hynin.

Pas tyre e mori fjalën Gjoka. Në klasë u bë përnjëherë zhurmë. U ndjenë lëvizje, pastaj zëra që aprovonin fjalët e sekretarit të Partisë së zonës.

E gjithë kjo nuk zgjati më shumë se një orë. Në prakun e derës dolën pas pak disa burra dhe pas tyre, Gjoka.

Shtati tij i madh mbylli për një çast gjithë hapësirën e derës. Ishte i gjëzuar. Në kokë mbante kapelen prej lëkure të zezë dhe ashtu dukej më shumë si punëtor sesa si fshatar. Ai liroi derën dhe pas tij dolën Ndoi, Istrefi, pastaj të tjerët me radhë. Njëri prej tyre, një burrë i shëndoshë, me pushkë në krah, iu afrua Gjokës.

— A ta shkrep njihërë, o shoku sekretar?, — tha ai duke qeshur. — Nji ditë e madhe si kjo e do nji pushkë.

— Shkrepe!, — tha Gjoka. — Shkrepe për gjëzim!

Malësori i shëndoshë hoqi pushkën nga krahu dhe në çast tërhoqi këmbëzën. Në hapësirën e kthjellët të atij mëngjesi të bardhë u dëgjua përnjëherë krisma e fuqishme e armës, jehonën e së cilës e përcollën shpatet shkrep më shkrep.

— Ooo, ç'asht pushka, more?... Oo, ç'asht pushka more?...

Ishte një zë i ri, i fortë, që dukej sikur ngjitej që nga thellësitë e maleve e i njoftonte fshatit kufirin midis dy botëve: njëra e vjetër dhe e ashpër, që mbeti diku mes grykave të ftohta dhe tjetra e re, e gjëzuar, që sapo lindi atë të diel në mëngjes.

Gjoka hapi krahët e tij të mëdhenj, qeshi një copë herë, pastaj u foli malësorëve. Të gjithë, në heshtje dhe duke thithur duhan nga llullat, u grumbulluan sërisht aty, në oborrin e shkollës.

Skena u improvizua në çast. Hapësira e vogël nën strehën e derës së jashtme të shkollës u bë atë mëngjes skena e parë e shfaqjes sonë të parë.

Blerta doli para gjithë atyre burrave e grave që vështronin me kureshtje dhe nisi të fliste. Fytyra e saj e ëmbël shkëlgente nga gjëzimi. Sanija kënaqej që ajo, mësuesja e saj e mirë ishte e gjëzuar dhe aty pranë meje buzëqeshi, duke lëshuar ca tinguj të ngrohtë, të këndshëm. Diku mes

burrave që thithnin pareshtur llullat, fytyra e qetë e Istrefit dukej sikur e aprovonte atë buzëqeshje të vajzës së vet. Edhe ai vuri buzën në gaz, kësaj radhe në mënyrë të dukshme.

Mëngjesi i bardhë i asaj së diele u bë i butë, i ngrohtë.

## IX

Kjo ishte një pjesë e jetës sonë të dikurshme në fshat. Dera e dhomës së pritjes, që në fillim më ngjau se u hap papritur, tani u mbyll dhe Blerta, Sanija e buqeta me lule të kaltra zunë secila vendin e vet. Në dhomë ishte çdo gjë si më parë. Dy globet atje lart, duke derdhur pareshtrur një dritë të butë e të verdhë, tavolina e gjatë që shkëllqente nga verniku dhe rrëth saj, Myzejeni, Liria, Genci e Blerta, që po i fliste diçka Aleksandrit me të qeshur.

Solla sërish nepër mend Sanjen. Atëherë, porsa mbaroi shfaqja, ajo erdhi në dhomën tonë dhe Blerta foli gjatë me të. Ishte tepër e emocionuar dhe gati sa s'fluturonte nga gëzimi. Me kënaqësi tha se tanimë çdo gjë shkoi në vendin e vet dhe ia krisi të qeshurit ashtu si më parë. Dhoma u mbush në çast me cicërimat e saja dhe të Sanijes...

Pas disa vitesh, unë u transferova. Po ashtu dhe Blerta. Nuk u takuam për disa vite, megjithatë, pas gjithë asaj kohe pa u parë, ajo qëndron sërish para meje. Veçse kësaj radhe me një ndryshim. Në fytyrën e saj gjithnjë të ëmbël ka tani një hije serioziteti, që më parë nuk e kishte. Unë e përqafoj dhe i them:

— Blerta! Të ka shkruar ndonjëherë Sanija?

Po, — tha ajo dhe papritmas u gjallërua. — Para disa muajsh më shkruante se e mbaroi me sukses Institutin e Lartë Pedagogjik në Shkodër dhe se e kanë emëruar në fshatin e saj.

— Me të vërtetë?, — thirra unë e gëzuar. — Po Istrefi?

— Edhe ai më shkruante dy-tri radhë, — qeshi Blerta.

— Të kujtohen ata gishtërinjtë e tij të trashë si patate? Me ata kishte shkruar këto fjale: «Mos na ke harrue krejt, oj mësuesja jonë? Të presim pra të vish ndonji ditë kën-dej nga ne. Kulla asht lye me gëlqere dhe unë do t'i bie lahatës për ty. Hajde! Istrefi».

— Kjo është një mrekulli, — thashë unë. — Po ti do të shkosh?

— Patjetër.

— Kur?

— Pas një muaji.

— Sa do të rrish?

— Ndoshta përgjithmonë, — qeshi ajo.

— Si?!, — mbeta një çast e hutuar.

— Aleksandri ka kërkuar të shkojë në fshat, Vera, dhe komiteti e aprovoi kërkesën e tij. E emëruan atje, në fshatin tonë si ekonomist i kooperativës dhe doemos, unë do të shkoj me të. Po në atë shkollë ku kemi qenë bashkë.

E vështrova për disa çaste në sy. Blerta kishte mbetur po ajo që kisha njohur dikur.

— Të lumtë, — fola unë dhe e përqafova.

— Prit, prit, — qeshi përsëri Blerta. — Ti ndoshta s'e di se kush është drejtor atje. As unë nuk e dija, po para një jave e mora vesh.

— Kush është?, — pyeta menjëherë me kureshtje.

— Sanija!

— Sanija??

— Po, po. Sanija. Nuk të mbushet mendja?

Mbeta një copë herë pa folur. Sanija drejtoreshë e shkollës dhe mësuesja e saj e dikurshme pranë?... Kjo ishte me gjithë mend një gjë e këndshme.

Dhoma e pritjes qe bërë e ngrohtë dhe sikur nga lart derdhej më shumë dritë se më parë. Liria u ul, pasi kishte deklamuar një poezi nga albumi i saj studentesk, ndërsa Genci mori kitaren dhe nisi t'i binte. Tingujt e saj u shpër-ndanë në fillim të ulët, të thellë, sikur vinin nga larg, pastaj ata u ngritën dhe e pushtuan plotësisht dhomën tonë të pritjes. Kjo qe një nga mbrëmjet e mia më të gëzuara.

## F U N D